Mal BERISHA



FISNIKËT SHQIPTAR DHE BESA SHQIPTARE

Tiranë, 2021

Mal BERISHA

FISNIKËT SHQIPTAR DHE BESA SHQIPTARE

Tiranë, 2021

Botim special në pak kopje, kortezi për Muzeun

“Solomon” të Beratit,

18 Shtator 2021

Në nderim të Prof. Scarlett Epstein

(Trude Grünwald) e cila e mbylli jetën me fjalët:

“Shqipëria më shpëtoi jetën”

Shtypur në shtypshkronjën e shtëpisë

Botuese FLESH

Tiranë 2021

Shqiptarët nuk kanë aq shumë gjëra për të eksportuar,

por ata kanë një produkt unik në botë:

BESËN SHQIPTARE”

Norman Greshman

*(*Kronikë veprimtarish për njohjen e Historisë së Fisnikëve Shqiptarë Midis Kombeve, të zhvilluara në Londër, New York, Gjenevë, Vjenë, Prishtinë, Tiranë.)

HYRJE

Pas Gjuhës Shqipe, një nga elementët që e dallojnë më shumë se çdo gjë tjetër njeriun shqiptar, është BESA. Ky term në kushtet e kozmopolitizmit dhe të zhvillimeve të sotme bashkëkohore duket se e humbet gjithnjë e më shumë kuptimin e vet. Kjo mbase ka filluar shumë kohë më parë, që atëherë kur në kohën e komunizmit filloi të përdorej termi:

"Sa doli shkresa, iku Besa!"

E prapëseprapë, brezi im, ende beson se "një fjalë e dhënë është një punë e bërë", pasi siç thotë populli ynë:

"Besa asht ma e fortë se vdekja",

“Besa e burrit, pesha e gurit”,

“Kur jep fjalën e ther djalën”.

Përmenda vetëm disa prej tyre.

Është pikërisht ky element i identitetit tonë, i cili më ka udhëhequr tërë jetën time në çdo moshë, në çdo rrethanë dhe në çdo rast dhe më ka bërë të besoj se nëse shqiptari ka një fibër të fortë integriteti dhe identiteti shqiptar dhe një personalitet të papërlyer, ai e vendos BESËN në mes të gjërave më të shtrenjta të jetës së tij.

Po të shkohet pak më tutje në kuptimin e kësaj fjale na del se gjëja për të cilën janë vlerësuar më shumë se për çdo gjë tjetër shqiptarët, është pikërisht BESA.

Ky liberth, përshkruan disa ngjarje që lidhen me bërjen me dije të huajve, sesi shqiptarët e thjeshtë i mbrojtën hebrejtë e vendit të tyre. Madje në numër edhe më të madh ata i mbrojtën edhe hebrejtë e huaj të cilët e gjetën Shqipërinë si një vend të sigurtë. E tërë kjo ka ndodhur në rrjedhë të historis, por më shumë se asnjëherë ra në sy në periudhën më të errët të historisë së tyre, atë të Holokaustit. E tërë kjo ka si shpjegim virtytin tonë të lartë:

Besën dhe Mikëpritjen Shqiptare.

Njohja e njerëzimit me këtë virtyt të popullit tonë dhe sesi po ky virtyt e dalloi kombin tonë nga gjithë kombet e tjera në qëndrimin që mbajti ndaj hebrejve, përbën një temë shumë të

vlefshme për diplomacinë shqiptare në çdo kohë, periudhë dhe pavarësisht nga qëndrimet politike të qeverive shqiptare të rradhës.

Kam nderin që këtë material ta paraqes në Muzeun e Solomonit në Berat me datën 18 Shtator 2021 si mirënjohje për mikun tim z. Gazmend Toska, i cili e ka sponsorizuar ngritjen e këtij muzeu. Po ashtu mbetet shumë vlerësues edhe puna e pa lodhur e studiuesit beratas z. Simon Vrusho.

Me këtë rast dëshiroj t'i dhuroj muzeut tre libra:

1.- Herman Bernstein – Ambasadori Amerikan në Mbretërinë Shqiptare 1930 – 1933;

2.- The Lost Messiah, nga John Freely

3.- Fisnikët shqiptar dhe BESA shqiptare, përgatitur enkas për këtë muzeum

KURRË MË!

NEVER AGAIN!

Nga Mal BERISHA

Në ditët Ndërkombëtare të Përkujtimit të Hollokaustit.

- Asnjë jetë hebreje nuk humbi në Shqipëri dhe as në Kosovë;
- 6 Milion hebrej u vranë nëpër Evropë!?

Çdo shqiptar duhet të përkulet me dhimbje për të rënët dhe me nderim përpara FISNIKËVE SHQIPTAR që ushtruan BESËN SHQIPTARE dhe treguan fisnikërinë dhe dinjitetin tonë!

Proud to be Albanian!

PËRKUJTOHET DITA E HOLOKAUSTIT NË UNIVERSITETIN MIDDLESEX

20 Janar 2013: Mbahet një kumtesë me titull: "BESA Shqiptare dhe Historia e Hebraizmit në Shqipëri" gjatë Ditës së Përkujtimit të Holokaustit në Universitetin Middlesex. Kjo veprimtari u organizua nga Worshipful Mayor

of Barnet, Councillor Brian Schama. Këshilltarë të zonës dhe pjesëmarrës të rëndësishëm, diplomatë dhe anëtarë të bashkësive të ndryshme ndoqën veprimtarinë si dhe një procesion të mbajtur nga Hendon Town Hall deri në Middlesex University Quadrangle.

Tema e shërbimit përkujtimor ishte **"Së bashku të ndërtojmë një urë",** i cili kërkonte dhe inkurajonte respekt për bashkësitë e ndryshme duke nderuar viktimat e genocidit: bashkësi të tilla, të cilat u shkatërruan nga Hollokausti nën përndjekjen naziste, por edhe më vonë si ato në Kamboxhia, Bosnjë, Ruanda, Darfur, etj. Në këtë ditë përkujtimore foli shefi i Misionit të Shqipërisë i cili tregoi për mënyrën se si Shqipëria i mbrojti hebrejtë gjatë Hollokaustit, si ata vendas ashtu edhe të

ardhurit nga vendet si Gjermania e Austria. Në fund të luftës Shqipëria ishte i vetmi vend në Europë i cili kishte më shumë hebrej së sa në fillim. Ai dha një pasqyrë të shkurtër por me plot fakte rreth marrëdhënieve midis dy popujve duke u ndalur tek gjurmët e hebraizmit që nga shekulli i V–të i erës së re me gjurmët e Sinagogës së Sarandës, Nathanailin e Gazës, Ambasadorin Bernstein etj. Shqipëria u cilësua vendi i 69 fisnikëve midis kombeve të gdhendur në Memorialin e Yad Vashemit.

MBRËMJE NË SINAGOGËN PINNER, LONDËR: PËRKUJTIM I TË RËNËVE TË GETOS SË VARSHAVËS

Më 7 Prill 2012 mora pjesë në natën përkujtimore të Yom Hashoah – të quajtur:

‘Një Mbrëmje Përkujtimore në Sinagogën Pinner’ në rastin 70-vjetorit të Kryengritjes në Geton e Varshavës. Tema e mbrëmjes ishte “Resistance and Rescue”. Folësi i parë i mbrëmjes ishte Ambasadori i Polonisë në Mbretërinë e Bashkuar Sh.T. z. Witold Sobkow dhe më pas fëmijët e të mbijeturave të Getos Polake, Janine Webber and Lili Stern-Pohlmann. Programi filloi me një ceremoni emocionale të ndezjes së qirinjëve dhe një shërbesë fetare të shkurtër, të pasuar nga lexime prej të rinjve. Qiriri i dytë u ndez për Shqipërinë, Bullgarinë dhe Danimarkën, popuj që i mbrojtën hebrejtë në ditët e vështira të Hollokuastit. Zonja Gaby Glassman, Kryetare e Komitetit të Yom Hashoah në fjalën e saj tha:

"Dua të nderoj shumë shqiptarë të cilët bazuar në kodin e tyre të nderit BESA, e cila kërkon që të huajit ti jëpet strehë kur njeriu i panjohur është në nevojë, dhe të trajtohet si mik".

Ajo falënderoi Ambasadorët e pranishëm, atë të Shqipërisë, të Gjermanisë, Polonisë, Hungarisë, Rumanisë, Sllovakisë, Austrisë dhe drejtorin e Qendrës së Institutit të Kulturës Polake.

“BESA – PREMTIMI”
– FILM NË KINEMANË KILBURN LONDËR

Mw 18 nëntor 2013, në kinemanë Triclycle Theatre Kilburn, Londër, u shfaq filmi “*Besa – The Promise”*, një produksion amerikan, i cili sjell përpara publikut hebraik të Londrës një histori

të jashtëzakonshme të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe hebrejve gjatë përiudhës së Holokaustit. Vështirë se mund të ketë një film i cili të jetë një krijim artistik dhe përsëri aktorë të jenë personazhet e vërtetë të ngjarjes; të jetë krijim artistik, por të mos ketë asnjë sajesë apo devijim nga e vërteta; të jetë dokumentar dhe të ruajë një natyrë krejt artistike; të jetë një tregim i një ngjarjeje dhe tregimtarë të jenë vetë njerëzit e ngjarjes…Kjo është historia e Rexhep Hoxhës, babai i të cilit jo vetëm që ka strehuar familjen e Aronit, hebre nga Bullgaria, gjatë luftës por i ka lënë amanet të birit të përmbushë Besën që i ka dhënë mikut të tij hebraik: T'i kthejë 3 librat e shenjtë të Torahut, libra të cilët ia besoi me shpresën se do të kthehej ti rimerrte kur lufta të mbaronte. Lufta mbaron. Shqipëria

zhytet në izolim. Filmi është vlerësuar me çmime të larta. “Besa – Premtimi, - ashtu siç thotë në fund të filmit, fotografi Norman Greshman - “është eksporti më i mirë që shqiptarët kanë dhe që i nderon dhe i veçon ata nga çdo popull”.

HISTORIA E PATREGUAR E SHPËTIMTARËVE SHQIPTARË NË SINAGOGËN PINNER



Më 16 Janar 2014 në Pinner Sinagogë, në një nga zonat me numrin më të madh të banorëve hebrej në Londër, u organizua shfaqja e filmit dokumentar BESA me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman. Më shumë se katërqind pjesëmarrës, prej të cilëve edhe një

numër i mirë shqiptarësh me banim në këtë qytet, ndoqën me vëmendje, respekt dhe emocion këtë veprimtari, e cila u hap me fjalën e zonjës Gaby Glassman, Kryetare e Këshillit Organizativ të Sinagogës Pinner. Ajo nënvizoi fisnikërinë dhe virtytet e larta të shqiptarëve të cilat bënë që asnjë hebre në atë vend të mos dorëzohej tek nazistët. Më pas audienca dëgjoi kujtimet e Prof Scarlett Epstein rreth përvojës së saj në Shqipëri.

PREZANTIM NË YIVO INSTITUTE OF JEWISH STUDIES NË NEW YORK

Më 14 Dhjetor 2014 pata mundësine e artë që të bëja një prezantim në YIVO Institute of Jewish Research në New York City përpara një audience të gjerë ku të pranishëm ishin amerikanë, amerikanë - hebrej, shqiptaro - amerikanë, studjues dhe të interesuar për lidhjet e Shqiptarëve me hebraizmin. Ky prezantim dha një pamje të gjerë të asaj se përse në Shqipëri gjatë kohërave më të vështira të Holokaustit, por edhe në etapa të tjera nuk u dëmtua asnjë hebre.

QENDRA HEBRAIKE JW3 PRET AMBASADORËT E SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Më 25 janar 2015, në Ditën Ndërkombëtare të Kujtesës së viktimave të Holokaustit, bashkë me Ambasadorin e Republikës së Kosovës morëm pjesë në mbrëmjen e organizuar nga

Qendra Hebraike JW3. Për këtë veprimtari u botua edhe një shkrim në Jerusalem Post. Modeli shqiptar i Besës që i mbrojti hebrejtë ishte tema e mbrëmjes.

LEKSION NË AMBASADËN AMERIKANE LONDËR – JETA E HERMAN BERNSTEIN



Më 4 qershor 2015 u mbyll_Java e kulturës shqiptaro-britanike, paa rastin që për herë të parë në historinë e Shqipërisë, të mbaja një leksion brenda në Auditorin e Ambasadës Amerikës në Londër. Aty u shpalos flamuri

shqiptar si dhe një xhevahir i historisë së Shqipërisë i titulluar: “Jeta e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Herman Bernstein në Mbretërinë Shqiptare si dhe Marrëdhëniet Shqiptaro – Hebraike si një model i tolerancës fetare”. Ky aktivitet u zhvillua me iniciativën e Ambasadorës Shqiptare në Londër dhe nën kujdesin e Ambasadorit Amerikan në Londer, Sh.T z. Matthew Barzun në bashkëpunim me Ambasadorin e Shtetit të Izraelit z. Daniel Taub dhe Abasadoren e Lituanisë zonjën Asta Skaisgiryte Liauskiene.

Lithuanian Ambassador Asta Skaisgiryté delivers remarks
Ambassador Berisha presents lecture
Q&A

SHPËTIMI NË SHQIPËRI

Historia e patreguar e Fisnikëve Shqiptar, të cilët i shpëtuan hebrejt nga Holokausti

Shkruar nga:

Harvey Sarner

Përkthyer nga Mal Berisha

NJË QINT PËRQINT E HEBREJVE NË SHQIPËRI TË SHPËTUAR NGA HOLOKAUSTI



Edhe para se të fillonte Lufta e Dytë Botërore Shqipëria ishte një parajsë për hebrejtë të cilët përpiqeshin të shpëtonin nga kthetrat e

nazistëve. Janë me mijëra ata që mundën të merrnin viza për të kaluar nëpër Shqipëri, ose edhe për të qëndruar, sipas dëshirës. Hebrejtë gjendeshin në Shqipëri që në fillim të erës së re, duke u shtuar në prurjet më të mëdha në shekulline XIX-të. Kur nazistët i kërkuan listat e hebrejve më 1943, qeveria shqiptare kundërshtoi t'i dorëzonte ato. Si përgjigje ndaj kësaj, populli shqiptar, musliman apo kristian pa dallim, iu dha strehë, bukë e mbrojtje dhe bëri që asnjë prej tyre të mos bëhej pre e Holokaustit. Deri vonë, Shqipëria, vendi i mbyllur i Ballkanit ndoqi një politikë izoluese, kështu që askush nuk mundi t'i bënte të njohura veprimet e fisnikëve shqiptarë. Në vitin 1991, shumica e bashkësisë hebreje u vendos në Izrael. Ata sollën me vete dokumente të cilat

tregonin se si shqiptarët i kishin shpëtuar duke rrezikuar veten e tyre e që pikërisht ky akt i madh unik, njerëzor duhej të gëzonte nderin që i takonte.

Harvey

Sarner

Botimi shqip i librit është bërë nën kujdesin e Lidhjes Qytetare Shqiptaro – Amerikane në Nju Jork dhe personalisht nga Presidenti i saj, ish Kongresmeni Joe DioGuardi
Shtypur në Shtëpinë Botuese KOHA, Tiranë 1998.

Copyright C 1997 prej Brunswick Press. Gjithçka i takon autorit. Asnjë pjesë e librit nuk

mund të riprodhohet në asnjë formë të saj pa leje me shkrim nga botuesi.

Një libër xhepi i titulluar, "Hebrejtë e Shqipërisë", është publikuar në vitin 1992 prej të njejtit autor dhe botues, kështu që pjesë të tij janë përmbledhur në këtë botim.

Numri i kartës së katalogut të Bibliotekës së Kongresit është 96-08023

Shtypur në Shtetet e Bashkuara te Amerikës

Botimi i Parë 1997

Published by Brunswick Press
Po. Box. 2244 Cathedral City, CA 92235
Co-published by the Frosina Foundation

LIDHJA QYTETARE SHQIPTARO – AMERIKANE DHE ROLI I SAJ NË NJOHJEN E HISTORISË SË HEBREJVE NË SHQIPËRI

Në tërë historinë e tyre të gjatë, shqiptarët e kanë dashur dhe inkurajuar paqen dhe bashkëpunimin midis popujve. Ata i kanë mirëpritur vizitorët e huaj ne brigjet e tyre duke shpalosur shpirtin e tyre miqësor. Kur refugjatet hebrej e gjetën rrugën e shpëtimit nëpër Shqipëri, populli shqiptar iu dha atyre strehë dhe mbrojtje pa marrë parasyshë rrezikun që sillte ky veprim.

Gjatë pushtimit fashist në Shqipëri, sikundër edhe në vendet e tjera të pushtuara gjatë Luftës

së Dytë Botërore, autoritetet naziste e mbajtën nën vëzhgim të rreptë popullatën hebreje duke u përpjekur të rregjistronin secilin prej tyre qoftë vendas apo i ardhur. Hebrejtë në Shqipëri lëviznin sa në një qytet në një tjetër, por më së shumti në Vlorë dhe Durrës për vetë rëndësinë strategjike që kishin këto qytete. Në një kohë kur nazistët i kërkonin hebrejte jo-shqiptar, shqiptarët pa marrë parasysh asnjë rrezik i ndihmuan ata fshehtas që të mos dorëzoheshin e më pas të dërgoheshin në kampet shfarosëse naziste. Në shtëpitë shqiptare ata gjetën bukë, strehë, mjete jetese e ngrohtësi familjare njerëzore.

Janë të shumta rastet kur familjet hebreje për t'i shpëtuar rrezikut kalonin nga një familje tek tjetra, nga një fshat në një tjetër dhe nga një

qytet tek tjetri. Disa herë atyre iu siguruan pasaporta false nga mikëpritësit e tyre shqiptar. Ata provuan të veshnin edhe rrobat e fshatarëve shqiptarë, të cilat ata vetë ua jepnin vetëm e vetëm për të mos i lëshuar në duart e nazistëve. Në këto përpjekje mbinjerëzore, shqiptarët jo rrallë u bënë pre e ndjekjeve, persekutimit e rrezikut për jetën e tyre.

Liga Civile Amerikano – Shqiptare u themelua në Janar të vitit 1989 për të shprehur vullnetin e 400.000 shqiptaro-amerikanëve për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe shqetësimin për gjendjen e shtatë milionë shqiptarëve të cilët jetojnë ndarazi në atdheun e tyre Ballkanik, Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë Perëndimore, Serbinë Jugore, (Preshevë), Veriun e Greqisë (Çamëri) e në Mal të Zi.

Si anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve nga viti 1985 deri më 1989 dhe si kryetar i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane, që në atë kohë e kam ngritur alarmin në mënyrë të përsëritur rreth trajtimit brutal që Sllobodan Milosheviç i bën popullit shqiptar në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Ballkanit të influencuara prej tij. Gjatë shumë udhëtimesh në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri kam drejtuar delegacione kongresmenësh, aktivistësh të të Drejtave të Njeriut si dhe gazetarë, për të vënë në pah kushtet e tmerrshme nën të cilat shqiptarët kanë qenë të detyruar të jetonin – nën komunizëm në Shqipëri për pesëdhjetë vjet që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe nën regjimin armiqësor sllav në ish – Jugosllavi.

Udhëtimin tim të parë në Shqipëri e kam bërë në qershor të vitit 1990 së bashku me kongresmenin Tom Lantosh, një hebre hungarez i shpëtuar nga Holokausti. Gjatë këtij udhëtimi na u dha mundësia që të shtinim në dorë një dosje e cila përmbante dokumente mbi veprat heroike të shqiptarëve, deri atëherë të papublikuara, ku bëhej fjale për shpëtimin e hebrejve gjatë luftës së Dytë Botërore. Në të vërtetë, ishte vetë presidenti i atëhershëm komunist i cili e ndjente frikën e ndryshimeve të detyrueshme, ai që ia dorëzoj zotit Lantosh dosjen, me synim qe të fitonte simpatinë e tij. Më tej, mbas kërkimesh të pandërprera u arrit që Yad Vashemi të njihte kombin shqiptar për veprimet e tij unike si një komb fisnik, i cili kishte ditur dhe guxuar të mbronte jo vetëm

hebrejtë e vet por gjithashtu edhe te gjithë ata që i kishin ikur nazizmit nga Europa dhe ishin strehuar në Shqipëri. Ky libër dëshmon qartë se sa të shtrenjtë e ka populli shqiptar lirinë, jo vetëm për veten e tij, por edhe për të tjerët. Vepra e fisnikëve shqiptar bën që të krenohemi përpara botës së qytetëruar, por edhe të kërkojmë prej saj që të mbajë të njëjtin qëndrim ndaj kërkesave tona të ligjshme humane e kombëtare.

Botimi i këtij libri është homazh ndaj virtytit shqiptar deri tani jo dhe aq të njohur. Në të njejtën kohë ai ka filluar të ketë ndikim të madh tek njerëzit që e lexojnë, duke i sensibilizuar ndenjat e tyre ndaj një kombi të tillë.

Por, qëllimi tjetër po kaq i madh është që tu tregojë shqiptarëve kudo në botë se kombet e forta mund të ngrihen edhe pas dymijë vjet përpjekjesh mbinjerëzore. Që të arrihet deri aty më së pari duhet kontributi i çdo individi të kombit, i harmonizuar me veprimet kolektive. Në këtë drejtim çdo shqiptari, kudo që ndodhet i bie barra të mendojë për të ardhmen e kombit tonë.

Me rastin e botimit shqip të këtij libri dëshiroj të falënderoj të gjithë miqt e mij të Lidhjes Qytetare Shqiptaro – Amerikane, shumë miq të mij hebrej në ShBA dhe në botë si dhe përkthyesin, mikun tim Mal Berisha, për dëshirën që shfaqi për ta sjellë tek shqipëfolësit këtë histori për të cilën çdo shqiptar duhet të ndjehet krenar.

Hon. Joseph DioGuardi

Lidhja Qytatare Shqiptaro – Amerikane

61 Central Ave

Ossining, NY10562

Tel: (914) 762-5530



IN MEMORIAM

Kushtuar Prof. T. Scarlett Epstein, OBE në ditën e vdekjes së saj, 27 Prill, 2014

NGA MAL BERISHA



Prolog

Profesor T. Scarlett Epstein ndërroi jetë me datën 27 Prill 2014, në moshën 92- vjeçare duke lënë pas kujtime shumë të vyera ndër të cilat nga më interesantet ato për Shqipërinë.

E njoha atë në ditët e para të punës time në Londër, kur kolegia ime diplomate, zonja Teuta Starova më njoftoi se Prof. Epstein dëshironte të më takonte dhe të njihej me mua. Kështu ndodhi. Ajo ishte një zonjë hebreje austriake e lindur dhe e rritur në Vjenë deri në moshën 16-vjeçe dhe e shpëtuar në Shqipëri ne vitet 1938 - 1939. I prirur për të ditur sa më shumë rreth historisë së hebrejve, e prita me shumë kënaqësi. Me pas, me Prof. Epsteinin na lidhi një miqësi e fortë. Ajo ishte një zonjë shumë e dashur për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me modestinë e njeriut të madh ajo më "mori për dore" në një udhëtim mrekullar të një jete që vërtetë impresionon çdokend që ka sado pak ndjesi njerëzore dhe dëshirë për të njohur e mësuar. Ajo kishte një karrierë të gjatë akademike dhe kërkimore si ekonomiste dhe antropologe, autore e 14 librave, shume artikujve dhe filmave dokumentarë. Ajo ishte nderuar me shumë çmime e tituj mes të cilëve titulli OBE (Urdhëri i Perandorisë Britanike) akorduar në vitin 2004. Takimi i fundit me të në Shkurt 2014 në Shtëpinë e Pleqve në Brighton mbetet i paharruar.

"TË NOTOSH KUNDËR RRJEDHËS"

Një ditë ajo më dhuroi një libër që kishte botuar rreth jetës së vet me titull: "Të notosh kundër rrjedhës" . Ky libër gjendet në bibliotekën time, dhe mban një përkushtim të shkruar me dorë nga autorja:

"Shenjë e vogël e një admirimi të madh" Scarlett."

Rrëfimi i saj në atë libër të le pa frymë pothuajse në çdo faqe të tij. Dhe unë mendova se bazuar në atë rrëfim të sinqertë e dramatik të Profesor Epsteinit të bëja të njohur historinë e saj që është e lidhur me ne shqiptarët, pikërisht në këtë ditë kur ajo u nda nga jeta. Ky libër i botuar në gjuhën angleze në vitin 2005 në Londër përmban historinë e një jete të vështirë dhe përcjell një mesazh të fortë:

"UNË JAM GJALLË FALË BUJARISË SHQIPTARE"!

Prof. T. Scarlett Epstein jetoi 92 vjet. Krejt e thinjur, timide, trupvogël ajo banonte në qytetin bregdetar Brighton të Britanisë së Madhe. Ajo gjendej përherë e pranishme mes nesh sa herë që bëheshin veprimtari të Ambasadës Shqiptare në Londër. Atë e gjeje aty ku flitej për Shqipërinë, aty ku tregohej historia e hebrejve dhe Holokaustit dhe mbrojtja që atyre iu kanë bërë shqiptarët në ditët më të vështira të historisë së tyre. E gjeje në shkolla, në universitete, në biblioteka, festivale filmi, takime të rëndësishme ndërkombëtare apo sinagoga. E gjeje në Uashington DC apo Nju Jork në mes shqiptarëve, në Universitetin e Vjenës apo në Parlamentin Europian në Bruksel, në Kembrixh apo Oksford por edhe në Tiranë. Dhe kudo, ajo përcillte këtë mesazh: "Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare"!

Historia e saj është një histori tejet e dhimbshme, si shumë të tilla për hebrejtë, por me një fund të lumtur. Ajo ngjet me historinë e thuajse tremijë hebrejve që shpëtuan në Shqipëri.

ANSCHLUSS – VJENË – ZAGREB

Prof. T. Scarlett Epstein, ishte lindur në korrik të vitit 1922 me emrin Trude Grünwald. Ajo bashkë me prindërit dhe vëllezërit e saj u vu në shënjestër të nazistëve në atë periudhë të njohur si Anschluss ose aneksim i Austrisë prej Gjermanisë naziste i cili ndodhi me 12 Mars 1938,. Përndjekjet ndaj tyre ishin të përafërta me ato që zhvilloheshin ndaj hebrejve në Gjermani. Kështu, si shumë familjeve të tjera, edhe familjes Epstein, tani në me emra të ndërruar, iu desh të linte Vjenën drejt një vendi më të sigurtë. Vajza e re 16 -vjeçare, e cila vazhdonte gjimnazin me plot ëndrra për të ardhmen, u ballafaqua me alternativën, jetë a vdekje. Kështu ajo e mori në dorë jo vetëm fatin e vet por edhe të prindërve të saj. Ajo arriti të siguronte viza hyrje në Jugosllavi dhe me ndihmën e xhaxhait që ishte një industrialist i madh, ata u vendosën në Zagreb. Por pas tre muajsh vizat e tyre skadonin dhe duhej të largoheshin nga Jugosllavia ose të dëboheshin me dhunë drejt vendit të origjinës. E vetmja mugëdalje ishte të sigurohej ndonjë vizë për ndonjë vend jashtë influencës së gjermanëve. Ky vend doli të ishte Shqipëria.

MBRETI ZOG DHE HEBREJTË

Vajza e re troket në dyert e shumë konsullatave të cilat gjendeshin në atë kohë në Zagreb por të gjitha i mbyllen me forcë përpara syve sapo ajo tregonte pashaportën e saj me germën "J" të damkosur në të nga nazistët. Në këto rrethana, xhaxhai i saj i thotë se ka një shpëtim: është Shqipëria. Një hebre tjetër i cili bënte tregëti me Shqipërinë i kishte thënë atij se Shqipëria kishte një agjenai tregtare në Zagreb e cila kryente edhe veprime konsullore dhe i priste hebrejtë bujarisht. Sipas xhaxhait, Shqipëria festonte një përvjetor të saj dhe Mbreti Zog kishte dhënë urdhër që të jepeshin viza hyrje turistike, madje edhe për hebrejtë. Krejt çfarë dinte ajo vajzë nga mësimet e gjeografisë dhe historisë për Shqipërinë ishte se ishte një vend i cili shtrihej në vijën bregdetare të Adriatikut dhe kufizohej me Jugosllavinë dhe Greqinë. Tani familja hebraike kishte tre zgjidhje: të fshihej nëpër Jugosllavi dhe të priste fatin e zi të dëbimit në Austri; të kthehej në Austri vetë dhe të përfundonte në ndonjë kamp përqëndrimi nazist, ose të shkonte në një vend të panjohur, në Shqipëri. Ajo arriti t'i bindte prindërit dhe vetëm tre ditë para skadimit të vizës trokiti në dyert e asaj zyre shqiptare. Konsulli shqiptar e priti atë me respekt dhe përkundër faktit që ajo i tregon se ishin hebre në kërkim me pashaporta me germën "J", ai i pajisi me viza. Ata menjëherë morën rrugën për në Split prej ku zunë një anije që do t'i zbarkonte në Durrës. Në anije ata u përcillen prej shumë hebrejve të cilët ishin zënë në kurthin e terrorit nazist. Me ata njerëz ajo nuk do të shihej më kurrë, pasi nuk i mbijetuan terrorit nazist.

Durrës – 20 Nëntor 1938.

Në këtë datë ata arrijnë në Durrës. Pasi zbarkojnë, priten nga dy hebrej gjermanë të cilët e kishin gjetur që më parë Shqipërinë si strehën e tyre mbrojtëse dhe jetonin në qytet. Ata i shoqërojnë dhe i vendosin në hotelin Metropol afër portit detar. Përshkrimi i saj rreth gjendjes së këtij hoteli nuk lë vend për ndonjë kënaqësi por pritja e shqiptarëve ndaj kësaj familje në dëshpërim të plotë së bën të ndjehesh krenar. Ajo e përshkruan Durrësin e asaj kohe si një qytet me popullsi të përzier muslimane dhe ortodokse, që jetonin në paqe. Pas disa javësh qëndrim në hotelin Metropol, familjes i ofrohet mundësia të qëndronte në një një farë kompleksi i cili ishte dhënë nga bashkia. Aty gjendeshin hebrej me shtetësi të ndryshme të cilët terrori nazist i kishte bashkuar në fatin e tyre. Ky kompleks banimi financohej nga Komiteti Ndërkombëtar Amerikan Hebraik i Ndihmave, natyrisht me pëlqimin e qeverisë së Mbretërisë Shqiptare.

JETA NË DURRËS – NËNTOR 1938 – 20 PRILL 1939

Nevoja për të mbijetuar e mëson njeriun më shumë se gjithçka tjetër në jetë sepse vlera e jetës dyfishohet pikërisht atëherë kur ajo bëhet e pasigurtë. Kështu Scarlett Epstein fillon të kërkojë punë dhe arrin të gjejë nxënës që dëshironin të mësonin gjermanisht. Ndër to ishin dy vajza, bijat e familjes Dovana, një nga familjet më të njohura në Durrës. Me këtë familje ajo krijon një lidhje të fortë miqësore që ka vazhduar deri sot që ajo ka vdekur. Sipas ligjit shqiptar, refugjatët nuk lejoheshin të punonin. Megjithatë ajo, falë miqësisë së mëngjithershme që ndiitton me shqiptarët ia del të bëhet mësuese edhe pse ishte ende aq re. Familja e saj trajtohet me një dashuri të veçantë jo vetëm nga banorët e thjeshtë të qytetit por edhe nga prefekti i Durrësit. Episodet e jetës së Scarlett Epstein në Durrës janë të gjitha aq piktoreske dhe interesante, por ajo çfarë mbetet në kujtesën e njeriut është se sa herë ajo i rrëfente qoftë në audienca, qoftë në biseda private apo edhe në librin e saj, është dashuria që ajo përjetoi në atë qytet, për të cilën ishte aq mirënjohëse. "Shqipëria më shpëtoi jetën" ishte kryefjala e çdo rrëfimi të saj. Megjithatë, ky nuk mund të ishte një vend me një të ardhme për hebrejtë e mësuar me tregti dhe profesione të tjera. Me dy vëllezër në Britani, Oton dhe Kurtin ajo vendos të përpiqet të bashkojë familjen pikërisht atje. Kështu arrin të sigurojë viza për vete dhe nënën e saj, por jo dhe për babain. Vizat do të skadonin me datën 30 prill 1939. Ndërkohë ndodh ajo të cilën Epstein e përjeton dhe e përshkruan si një dëshmitare okulare me detajet e mëposhtme:

DËSHMITARE E PUSHTIMIT FASHIST ITALIAN – 7 PRILL 1939

Epstein tregon në librin e saj se mëngjesi i së premtës së mire, 7 prill 1939 u gdhi në Durrës bashkë me anijet që kishin filluar të dukeshin mizëri në brigjet e qytetit. Banorët e qendrës ku ishin strehuar refugjatët hebrej ishin udhëzuar të largoheshin dhe të hynin thellë në territorin e vendit pasi qendra e tyre ishte pranë policisë e cila kishte dy mitraloza. Ky do të ishte edhe objektivi kryesor i italianëve që do të thoshte se mund të dëmtonte seriozisht banorët e qendrës. Në qytet gjendeshin vetëm disa ushtarë të ushtrisë shqiptare. Hebrejtë vendosën të fshiheshin në qilarin e një shtëpie pranë komunës. Luftimet vazhdonin dhe ndjeheshin të shtënat. Hebrejtë prisnin çfarë do të ndodhte me ta dhe si do silleshin italianët?! Scarlett nuk e dinte nëse edhe italianët ishin anti-semitistë po aq sa ishin gjermanët. Hebrejtë vendosën të largoheshin duke marrë me vete vetëm gjërat me të lehta të mundshme. U larguan nëpër një fushë ku plumbat iu shkonin sipër kokës, për tu strehuar më pas në një shtëpi ku mundën të arrinin. Shkëmbimi i zjarrit midis forcave italiane dhe atyre shqiptare zgjati disa orë. Ajo dëshmon se kishte parë njerëz të vrarë dhe të mbetur në rrugë.

PËRBALLË PUSHTUESIT ITALIAN – MIKU I ARMIKUT BËHET MIK I HEBREJVE

Pas pak grupi i hebrejve u ballafaqua me italianët. Me bajonetat e armëve të hapura, ata iu dhanë urdhër të ndalonin. Në krye të turmës ishte vajza Scarlett, jo vetëm për guximin, por edhe se ishte e vetmja që fliste italisht. Ajo iu tha italianëve se ne jemi gjermanë. Italianët menjëherë iu kthyen atyre me dashamirësi duke iu thënë: "Gjermanët dhe italianët janë miq" pa e vënë re faktin që si hebrej që ishin, ata ishin armiqtë më të mëdhenj të Hitlerit i cili po i ndiqte këmba-këmbës. Ajo i shpjegoi komandantit italian se ata kishin dalë nga shtëpia nga frika e ushtrit italian, por tani dëshironin të ktheheshin përsëri atje. Italiani i siguroi se meqë ishin gjermanë konsideroheshin miq ndaj do t'u garantonin mbrojtje duke ndemar kështu marrëdhëniet që ekzistonin midis dy vendeve. Kështu, sado që të duket si një shaka, ata u vënë nën kujdesin italian dhe u kthyen ne shtëpi, pa menduar se kë po mbronin ata realisht në këtë situatë. Me këtë premtim ata nuk po kup-

IN MEMORIAM

Në ditën e vdekjes së T. Scarlett Epstein, OBE

Dëshmitare okulare e ditës së pushtimit fashist italian të Shqipërisë

Njohja me Profesor Epstein

Profesor Scarlett Epstein ndërroi jetë, dje më datën 27 Prill 2014, në moshëm 92-vjeçare duke lënë pas kujtime shumë të vyera, ndër të cilat ato për Shqipërinë janë nga më interesantet. E njoha atë në ditët e para të punës time në Londër, kur kolegia ime diplomate, zonja Teuta Starova më njoftoi se Prof. Epstein dëshironte të më takonte dhe të njihej me mua. Megjithëse kisha dëgjuar për të, mund të them se kisha pak njohje rreth saj. Ajo ishte një zonjë hebre austriake e lindur dhe e rritur në Vjenë deri në moshën 16 vjeçe dhe e shpëtuar në Shqipëri në vitet 1938 - 1939. I prirur për të ditur sa më shumë rreth historisë së hebrejve, e prita me

shumë kënaqësi. Me professor Epsteinin na lidhi më pas një miqësi e fortë. Ajo ishte një njeri shumë i dashur për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me modestinë e njeriut të madh ajo më "mori për dore" në një udhëtim rrëfimtar të një jete që vërtetë impresionon çdokënd që ka sado pak ndjesi njerëzore dhe dëshirë për të njohur e mësuar në këtë botë. Më pas, me Profesor Epstein, kemi organizuar e ndjekur shumë veprimtari të përbashkëta të lidhura me ne shqiptarët.

"Profesor Epstein kishte gjithashtu një karrierë të gjatë akademike dhe kërkimore si ekonomiste dhe antropologe e zhvillimit. Me studimet dhe punën e saj në bashkësitë rurale në Indi, Papua Neë Guinea e shumë vende të tjera, që prej

viteve ’50, ajo fillon të sfidojë teoritë klasike të zhvillimit e të varfërisë, bazuar atëherë e për shumë dhjetë-vjeçarë mbi faktorë monetarë, duke i hapur rrugën edhe studimeve mbi zhvillimin njerëzor e vafërinë multi-dimensionale të fitueses së çmimit Nobel për ekonominë, Amartya Sen.

Në karrierën e saj gati 60-vjecare, ajo ka publikuar dhjetra artikuj, ka botuar 14 libra, si dhe ka xhiruar dokumentarë mbi antropologjinë, zhvillimin social, fuqizimin e gruas si faktor në çrrënjosjen e varfërisë, etj. Ajo është nderuar me shumë çmime e tituj mes të cilëve titulli OBE (Order of the British Empire) akorduar në vitin 2004.

Krahas postit të saj akademik si pedagoge në Universitetin e Sussex, ajo ka punuar për dhjetra projekte me Bankën Botërore, Kombet e Bashkuara, USAID, etj në Indi, Afrikë, Azi Juglindore, Kinë, etj.

Deri në ditët e fundit të jetës ajo mbeti e dedikuar për çështjen që ishte bërë prej vitesh qëllimi i saj kryesor: mirënjohja ndaj popullit shqiptar e promovimi i vlerave të tij humane. Kjo mirënjohje e motivoi që të ndërmerrte edhe projekte mbi krijimin e mundësive ekonomike dhe sociale për grupe grash në zona të ndryshme rurale të Shqipërisë nëpërmjet OJQ-ve britanike me të cilat ishte e angazhuar."

“Të notosh kundër rrjedhës”

Një ditë ajo më dhuroi një libër që kishte botuar rreth jetës së saj me titull:
“Të notosh kundër rrjedhës”. Ky libër gjendet në bibliotekën time, dhe mban një përkushtim të shkurtër nga autorja: “Një shenjë e vogël e një admirimi të madh” Scarlett.”
Rrëfimi i saj në atë libër të le pa frymë thuajse në çdo faqe të tij. Dhe unë mendova se bazuar në atë rrëfim të sinqertë e dramatik të Profesor Epsteinit të bëja të njohur historinë e saj që është e lidhur me ne shqiptarët, pikërisht në këtë ditë kur ajo u nda nga jeta.
Ky libër i botuar në gjuhën angleze në vitin 2005 në Londër përmban historinë e një jete e një mesazh të fortë:

"Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare"!

Prof. Scarlett Epstein ishte në të 92-at, krejt e thinjur e trupvogël. Ajo banonte në qytetin bregdetar Brighton të Britanisë së Madhe. Që kur e njoha, nëse dikush dëshironte ta takonte, ajo ishte përherë e pranishme sa herë që bëheshin veprimtari të Ambasadës Shqiptare në Londër, aty ku flitej për Shqipërinë, aty ku tregohej historia e hebrejve dhe Holokaustit dhe mbrojtja që atyre iu kanë bërë shqiptarët në ditët më të vështira të historisë së tyre, ato të mbijetesës. E papërtueshme të merrte trena, metro, e gjeje në shkolla, në universitete, në biblioteka, festivale filmi, takime të rëndësishme ndërkombëtare apo sinagoga. E gjeje në Washington DC apo New York në mes

shqiptarëve, në Universitetin e Vjenës apo në Parlamentin Europian në Bruksel, në Kembrixh apo Oksford... Dhe kudo, ajo përcillte këtë mesazh: "Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare"!

Historia e saj është një histori tejet e dhimbshme, si shumë të tilla për hebrejtë, por me një fund të lumtur. Ajo sado individuale, ngjet me historinë e shumë hebrejve që shpëtuan në Shqipëri. I ngjet historisë së Irenë Grubman, të Mandilëve e sa e sa të tjerave.

Anschluss – Vjenë – Zagreb

T. Scarlett Epstein, e lindur në korrik të vitit 1922 me emrin Trude Grünëald, bashkë me prindërit dhe vëllezërit e saj u vu në shënjestër

të nazistëve në atë periudhë të njohur si *Anschluss* ose aneksim i Austrisë prej Gjermanisë naziste, i cili ndodhi më 12 Mars 1938. Ndjekjet ndaj tyre ishin të përafërta me ato që zbatoheshin ndaj hebrejve në Gjermani. Kështu, si shumë familjeve të tjera, edhe familjes Epstein iu desh të linte Vjenën drejt një vendi më të sigurtë. Vajza e re 16-vjeçare, e cila vazhdonte gjimnazin me plot ëndrra për të ardhmen, u gjet në mes të një familjeje të pashpresë dhe të frikësuar. Kështu ajo e mori në dorë jo vetëm fatin e vet, por edhe të prindërve të saj. Skarlet arriti të siguronte viza hyrje në Jugosllavi dhe me ndihmën e xhaxhait që ishte një industrialist i madh, ata u vendosën në Zagreb. Por pas tre muajsh vizat e tyre skadonin dhe duhej të largoheshin nga

Jugosllavia ose të deportoheshin me dhunë drejt vendit të origjinës. E vetmja rrugëdalje ishte të sigurohej ndonjë vizë për ndonjë vend jashtë influencës së gjermanëve.

Mbreti Zog dhe hebrejtë

Vajza e re troket në dyert e shumë konsullatave, të cilat gjendeshin në atë kohë në Zagre, por të gjitha ii mbyllen me forcë përpara syve sapo ajo tregonte pasaportën e saj me germën "J" të vulosur në të nga nazistët. Në këto rrethana, xhaxhai i saj i thotë se ka një shpëtim: është Shqipëria. Një hebre tjetër i cili bënte tregëti me Shqipërinë i kishte thënë se Shqipëria kishte një agjensi tregtare në Zagre, e cila kryente edhe veprime konsullore. - Pse nuk përpiqemi atje

një herë? Ndoshta...!? Sipas xhaxhait, Shqipëria festonte një jubile të saj dhe Mbreti Zog kishte dhënë urdhër që të jipeshin viza hyrje turistike, madje edhe për ata që mbanin pasaporta si e tyre. E tillë ishte gjithë familja e Scarlett-it, me këtë damkë. Gjithçka çfarë dinte ajo vajzë nga mësimet e gjeografisë dhe historisë për Shqipërinë ishte se ishte një vend i egër i cili shtrihej në vijën bregdetare të Adriatikut dhe kufizohej nga Jugosllavia dhe Greqia. Tani familja hebre kishte tre zgjidhje: të fshihej nëpër Jugosllavi dhe të priste fatin e zi të dëbimit në Austri; të kthehej në Austri dhe të përfundonte në ndonjë kamp përqëndrimi nazist, apo të shkonte në një vend të panjohur nga ana gjeografike por as si një vend anti-semitist?! Vasha arriti ti bindte prindërit dhe vetëm tre

ditë para skadimit të vizës ajo trokiti në dyert e asaj zyre shqiptare. Zyrtari shqiptar e pret atë me kortezi dhe përkundër faktit që ajo i tregon se ishin hebrej në kërkim me pasaporta me germën "J", ai i pajis me viza. Ata menjëherë marrin rrugën për në Split për të marrë një anije që do t'i zbarkonte në Durrës. Nga Zagrebi ata përcillen prej shumë hebrejve të cilët, ishin zënë në kurthin e tmerrit nazist. Me ata njerëz Scarlett Epstein nuk dotë shihej më kurrë...

Në Durrës

Më datën 20 nëntor 1938 ata nisen për në Durrës. Pasi zbarkojnë, ata priten nga dy hebrej gjermanë, të cilët e kishin gjetur që më parë Shqipërinë si strehën e tyre mbrojtëse dhe

jetonin në atë qytet. Ata i shoqërojnë dhe i vendosin në hotelin Metropol afër portit detar. Përshkrimi i saj rreth gjendjes së këtij hoteli nuk lë vend për ndonjë kënaqësi apo komoditet por pritja e shqiptarëve ndaj kësaj familje në dëshpërim të plotë të bën të ndjehesh krenar. Ajo e përshkruan Durrësin e asaj kohe si një qytet me popullsi të përzier muslimane dhe ortodokse, që jetonin në paqe. Pas disa javësh qëndrim në hotelin Metropol, familjes i ofrohet mundësia të qëndronte në një farë kompleksi, i cili ishte dhënë nga komuna. Aty gjendeshin hebrej me shtetësi të ndryshme të cilët tmerri nazist i kishte bashkuar në fatin e tyre të përbashkët. Ky kompleks banimi financohej nga Komiteti Ndërkombëtar Amerikan Hebraik

i Ndihmave, natyrisht me pëlqimin e qeverisë së Mbretërisë Shqiptare.

Jeta në Durrës – Nëntor 1938 – 20 Prill 1939

Nevoja për të mbijetuar e mëson njeriun më shumë se gjithçka tjetër në jetë sepse vlera e jetës dyfishohet pikërisht atëherë kur ajo bëhet e pasigurtë. Kështu Scarlett Epstein fillon të kërkojë punë dhe arrin të gjejë nxënës që dëshironin të mësonin gjermanisht. Ndër to ishin dy vajza, bijat e familjes Dovana, një nga familjet më të njohura në Durrës.Me këtë familje ajo krijon një lidhje të fortë miqësore që ka vazhduar deri sot që ajo ka vdekur. Sipas ligjit shqiptar, refugjatët nuk lejoheshin të punonin. Megjithatë, ajo falë miqësisë së

mënjëherëshme që ndërton me shqiptarët ia del të bëhet mësuese edhe pse ishte ende shumë e re. Familja e saj trajtohet me një dashuri të veçantë jo vetëm nga banorët e thjeshtë të qytetit por edhe nga prefekti i Durrësit. Episodet e jetës së Scarlett Epstein në Durrës janë të gjitha aq piktoreske dhe interesante, por ajo çfarë mbetet në kujtesën e njeriut është se sa herë ajo i rrëfënte qoftë në audienca, qoftë në biseda private apo edhe në librin e saj, është dashuria që ajo përjetoi në atë qytet, për të cilën ishte aq mirënjohëse. "Shqipëria më shpëtoi jetën" ishte kryefjala e çdo rrëfimi të saj Megjithatë, ky nuk mund të ishte një vend me një të ardhme për hebrejtë e mësuar me tregti dhe profesione të tjera. Me dy vëllezër në Britani, Oton dhe Kurtin ajo vendos të përpiqet

të bashkojë familjen pikërisht atje. Kështu arrin të sigurojë viza për vete dhe nënën e saj, por jo edhe për babain. Vizat do të skadonin me datën 30 prill 1939. Ndërkohë ndodh ajo të cilën Epstein e përjeton dhe e përshkruan si një dëshmitare okulare me detajet e mëposhtme:

Dëshmitare e pushtimit fashist Italian – 7 prill 1939

Epstein tregon në librin e saj se mëngjezi i së premtës së mirë të atij prilli e gjeti Durrësin pothuajse të zbrazur. Anijet kishin filluar të dukeshin mizëri në brigjet e qytetit. Banorët e qendrës ku ishin strehuar refugjatët hebrej ishin udhëzuar të largoheshin dhe të hynin thellë në territorin e vendit pasi qendra e tyre ishte pranë

policisë e cila kishte vetëm dy mitralozë. Ky do të ishte edhe objektivi kryesor i italianëve që do të thoshte se mund të dëmtonte seriozisht banorët e qendrës. Në qytet gjendeshin vetëm disa ushtarë të ushtrisë shqiptare. Hebrejtë vendosën te futeshin në një qilar në një shtëpi pranë komunës. Luftimet vazhdonin dhe ndjeheshin të shtënat. Hebrejtë prisnin çfarë do të ndodhte me ta dhe si do silleshin italianët. Scarlett nuk e dinte nëse edhe italianët ishin anti-semitistë po aq sa ishin gjermanët. Hebrejtë vendosën të largoheshin duke marrë me vete vetëm gjërat me të lehta të mundshme. U larguan nëpër një fushë ku plumbat iu shkonin sipër kokës, për tu strehuar më pas në një shtëpi ku mundën të arrinin. Me vete kishin marrë vetëm portofolet me letrat, paratë dhe

kush kishte diplomat edhe dekoratat e Luftës së Madhe. Shkëmbimi i zjarrit midis forcave italiane dhe atyre shqiptare zgjati vetem disa orë. Ajo dëshmon se kishte parë njerëz të vrarë dhe të mbetur në rrugë siç i kishte parë në Stacionin Karl Marks. Ushtarët shqiptarë kishin marrë rrugët dhe ruheshin të mos binin në dorë të gjermanëve.

Përballë pushtuesit Italian – miku i armikut bëhet mik i hebrejve

Pas pak hebrejtë u ballafaquan me italianët. Ata i kishin hapur bajonetat e armëve dhe iu dhanë udhër të ndalonin. Në krye të turmës ishte vajza Scarlett, jo vetëm për guximin, por edhe se ishte e vetmja qe fliste italisht. Ajo iu tha italianëve se

ne jemi gjermanë. Italianët menjëherë iu kthyen atyre me dashamirësi duke iu thënë: "Gjermanët dhe italianët janë miq" pa e vënë re faktin që si hebrej që ishin, ata ishin armiqtë më të mëdhënj të Hitlerit, i cili po i ndiqte ata këmba -këmbës. Ajo i shpjegoi komandantit italian se ata kishin dalë nga shtëpia nga frika e sulmit italian, por tani dëshironin të ktheheshin përsëri atje. Italiani i siguroi se meqë ishin gjermanë konsideroheshin miq, ndaj do t'ju garantonin mbrojtje duke nderuar kështu marrëdhëniet që ekzistonin midis dy vendeve. Kështu, sado që të duket si një shaka, ata u vunë nën kujdesin italian dhe u kthyen në shtëpi, pa menduar se kë po mbronin ata realisht në këtë situatë.

Kjo ngjarje e treguar nga Profesor Epstein më kujtoi tregimin e Agnes Jansen – Magerich,

infermerja amerikane që ra me avionin amerikan më 8 nëntor 1943 në fshatin Peshtan afër Beratit, vetë e tridhjeta. Grupi i amerikanëve, pas aksidentit që pësuan marshuan mespërmes qytetit të Beratit i cili ishte i pushtuar nga gjermanët. Aty operonin edhe partizanët edhe ballistat. Ndërsa populli doli me lule duke menduar se kishin ardhur aleatët dhe e kishin çliruar qytetin.

Por le të kthehemi tek hebrejtë të cilët të vënë nën mbrojtjen italiane nuk po kuptonin nëse këta të fundit ishin aty për ti mbrojtur, apo për t'i ndëshkuar ata. Scarlett, përfshihet në bisedë me ushtarë italianë nga Milano dhe Napoli. Madje ajo e tregon jo pa humor faktin që aleatët

e Hitlerit, armikut më të madh të hebrejve, ishin kthyer në mbrojtës të tyre.

Sapo arritën në shtëpi, ajo sheh një djalosh shqiptar në rrugë, i mbetur vetëm në të brendshme dhe që i kërkoi disa rroba për tu mbuluar dhe për të shpëtuar. Kuptohej që ai duhej të ishte ndonjë ushtar shqiptar i një ushtrie tashmë të shpartalluar. Ajo i jep atij rrobat e të jatit, "në shenjë shpërblimi ndaj asaj të mire që kishin bërë shqiptarët në atë periudhë të tmerrshme".

Pushtimi përfundoi të nesërmen e së Premtes së mirë dhe italianët vijuan drejt Tiranës. Hebrejtë mbetën në Durrës ndërsa Scarlett merr një letër nga prefekti i Durrësit, ish-konsulli italian që tashmë ishte transformuar nga konsull në prefekt të pushtuesit. Ai i

kërkonte asaj të vazhdonte t'i jepte mësim në gjuhën gjermane siç kishte bërë edhe më parë. Ai i premtonte asaj se përsa kohë të ishte ai në atë detyrë asgjë nuk do të ndodhte me ta nga ushtria italiane.

Vite më vonë ajo interesohet të mësoje për fatin e Luigi Aloisit që ishte pikërisht konsulli që me veprën e tij kishte sfiduar jo pa rrezik ligjet anti-raciale të Italisë fashiste

Largimi nga Shqipëria

Kur rrjedhja e ngjarjeve mori drejtim tjetër, Scarlett Epstein-it nuk i mbetej gjë tjetër veçse të përdorte vizën angleze të cilën ia kishin siguruar vëllezërit. Kështu, më datën 20 prill 1939, ajo bashkë me nënën e saj, niset për një

udhëtim tejet të rrezikshëm nëpër Itali dhe më pas Berlin, Koln, Amsterdam, Londër. Vitet e mëtejshme të jetës së kësaj zonjë janë të mbushura plot e përplot me ngjarje, por historitë plot vuajtje dhe rrezik u skalitën në kujtesën e saj duke memorizuar të shkuarën dhe duke ecur përpara udhëve plot të papritura të jetës. Megjithëse jetën si emigrante në Angli e fillon me sakrifica e duke qepur uniforma për ushtarët anglezë të Luftës së dytë Botërore, falë forcës e vullnetit të saj ajo arrin të vzhdojë studimet universitare, të bëjë doktoraturën e të bëhet profesoreshë dhe një ndër antropologet më të njohura në Britaninë e Madhe.

Miqësia me Profesor Epstein

Me Profesoreshën Epstein na lidhi një miqësi e fortë, e sinqertë dhe e bazuar në ndjenjat e bukura të mirënjohjes, mikëpritjes dhe Besës shqiptare. Ajo ka lënë dy vajza, Debby dhe Michelle, por në fakt edhe një zonjë shqiptare, ish Ministre Këshilltare e Ambasadës shqiptare në Londër, një pedagoge e nderuar dhe diplomate e shkëlqyer, Dr Teuta Starova që i ishte bërë vajza e saj e tretë. Ditë e netë të tëra, ajo i kalonte ose duke biseduar, lëvizur, shkuar nëpër universitete, sinagoga, shkolla për të folur për shqiptarët, ose në telefonta të gjata duke bërë plane se si ta propagandonin vlerën shqiptare të bukës, besës e mikpritjes edhe në mjedise joshqiptare.

Në vitin 2012, në Viener Library, në Londër u organizua një takim kushtuar Prof. Scarlett Epstein në prani të bashkësisë hebraike dhe shqiptare të Londrës. Atë veprimtari e nderoi edhe Ambasadori i Izraelit në Britaninë e Madhe, Sh.T. z. Daniel Taub. Aty ajo u nderua me simbolin e qytetit të Tiranës. Po ashtu kishte ardhur edhe Ingrid Strati, një intelektuale e njohur shqiptare nga Durrësi, me qëndrim në Itali, pasardhëse e familjes së shquar patriote të Dovanave. Me atë familje Scarlett kishte rivendosur kontaktet vetëm pak kohë më parë me ndihmën e një tjetër diplomateje të Ambasadës shqiptare, zonjën Xhoana Papakostandini, që fati kishte dashur që jo vetëm të ishte nga Durrësi, por edhe që familja

e saj të kishte miqësi me familjen Dovana. Dukej se edhe pas 74 vjetësh buka e Dovanajave nuk ishte harruar nga Epstein dhe as mirënjohja për ta e për Durrësin nuk ishte shuar. Kështu, në pranverën e vitit 2012 ajo udhëtoi në Durrës, për të rishkelur ato rrugë të memories, e për të xhiruar një dokumentar mbi historinë e saj në atë qytet.

Po në vitin 2012, Scarlett Epstein udhëtoi për në Washington DC për të marrë pjesë në përkujtimin e përpjekjve të shqiptarëve për të mbrojtur hebrejtë gjatë Hollokaustit. Më pas, e ftuar nga Vatra festuam bashkë 100-vjetorin e Pavarësisë, të ftuar nga shqiptarët e New Jorkut. Në vitin 2014, pas një sërë aktivitetesh mbi Shqipërinë ajo mbajti një fjalim të gjatë në

Parlamentin Europian për Besën shqiptare, e cila u prit me një admirim të jashtëzakonshëm.

Epilog

Respekti për këtë zonjë është i pafund. Vërtetë që shqiptarët kanë bërë për këtë zonjë atë që bëjnë për çdo njeri që iu troket në derë por edhe ajo ua shpërbleu me aq shumë punë dhe kujtesë vitale për ta bërë të njohur këtë histori kudo, atje ku shqiptarët kanë nevojë për njohje,

përkrahje dhe ngrohtësi. Para pak kohësh e vizitova në Brighton bashkë me zonjën time Donikën dhe ish diplomaten e ambasadës Xhoana Papakostandinin. Takimet e bisedat me të ishin jo vetëm të një kënaqësie të veçantë, por edhe një detyrim moral ndaj një lidhjeje historike midis shqiptarëve dhe hebrejve, dy popuj që e kanë siguruar lirinë me aq mundime vuajtje e përpjekje. Historitë, edhe ato të vetëm një jete, ashtu si ato të popujve të tërë, janë për tu nderuar dhe kujtuar. Ato në brendinë e tyre jetojnë si personazhe të tilla që në një çast historik të dhrojnë atë që as vite të tëra historie nuk ta falin dot: përjetësinë e virtytit.

Scarlett Epstein tanimë është e vdekur dhe do të varroset më datën 29 Prill në Brighton. Por ajo la një histori, e cila nuk duhet harruar.

Ndoshta ky shkrim është një peng nderi ndaj asaj që Shqipëria bëri për të dhe ajo që ajo bëri për Shqipërinë.

U prehtë në Paqë!

Mal Berisha

DY FJALË PËR LIBRIN: "IZREALITËT NË SHQIPËRI" TË AUTORIT JOSEF JAKOEL

Nga Mal BERISHA


Josef Jakoel
Izraelitët në Shqipëri
ÇABEJ

KY LIBËR DOLI NË DRITË NJËHERËSH ME NJOHJEN RECIPROKE QË REPUBLIKA E KOSOVËS DHE SHTETI I IZRAELIT I BËNË NJERI-TJETRIT DHE VENDOSËN MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE. KY ËSHTË NJË OGUR I MIRË PËR TË DY VENDET MIKE.

Josef Jakoel, është emri i një izraeliti i cili sot për shumë njerëz mund të tingëllojë si një emër i "ri" dhe jo aq i njohur.

Por, për shumë të tjerë ai emër ka një kuptim të madh. Për bashkëkohësit e tij, ai ishte një pedagog dhe njeri euridit në Institutin Bujqësor në Tiranë, një teknicien dhe punëtor i palodhur

në përhapjen e progresit në fushën e bujqësisë së vendit tonë, një zyrtar i Ministrisë së Bujqësisë. Po aq i njohur është ky emër edhe për shumë shqiptarë që i kanë njohur vajzat e tij Feliçitën dhe Ksenian, të cilat u lindën dhe jetuan në mesin e shqiptarve deri në vitin 1991. Për të bërë një hyrje sa më kuptimplote në këtë analizë të thjeshtë të këtij libri po e citoj vetë autorin e librit kur thotë:

"Jam krenar që në dejet e mia rrjedh gjaku i stërmunduar i Abrahamit, Isakut dhe Jakovit. Jam po aq krenar që u linda, u rrita, punova dhe u mplaka në gji të popullit shpirtmadh dhe fisnik shqiptar".

Emri i Josef Jakoel u shfaq në mediat amerikane fill pas rënies së komunizmit. Në vitin 1992, Harvey Sarner, një filantrop i njohur hebre – amerikan, botoi një libër me titull:

“Hebrejtë në Shqipëri”. Libri bazohej në dokumente dhe shënime që autori i mori prej Josef Jakoel dhe të bijës, Feliçita Jakoel, në Izrael.

Në vitin 1997, libri “Hebrejtë në Shqipëri” u ribotua me një titull tjetër, “Shpëtimi në Shqipëri – Një qint për qint e hebrejve të shpëtuar nga Holokausti.” Ai u plotësua me nga një parathënie prej Joseph DioGuradit, ish kongresmen dhe Presidenti Ligës Qytetare Shqipatoro Amerikane, kongresmenit Tom Lantosh dhe atij, Benjamin Gilman.

Ai libër, të cilin me autorizim të vetë Kongresmenit DioGuardi, kam patur nderin ta përkthej në gjuhën shqipe, ka në qendër emrin e Josef Jakoelit, një izraelit i Shqipërisë i cili kishte

mbajtur një evidencë të plotë të pranisë fizike hebraike në Shqipëri. Autori, Harvey Sarner, i bën atij një dedikim shumë të ndjerë:

"Ky libër i kushtohet kujtimit të Josef Jakoel – Një Mose i shekullit të XX – të, i cili iu priu bashkëatdhetarëve të tij drejt Tokës së Premtuar."

Ai përshkruan me emra dhe fakte se si dhe përse hebrejtë u shpëtuan nga shqiptarët gjatë periudhës më të errët të historisë së njerëzimit; Holokaustit.

Deri në vitin 1990, përmendja e një historie të tillë ishte një tabu dhe mund të përbënte rrezik për rrëfenjësit e saj.

Që kur Josef Jakoel i dha ato evidenca dhe deri më sot kur është botuar libri në fjalë, thuajse të

tërë autorët janë bazuar në dëshmi të dorës së dytë.
E drejta vonon por nuk harron.

Dhe ja më në fund, edhe pse pak me vonesë, lexuesit shqiptar i jepet në dorë një libër që tregon një histori sa interesante aq edhe tronditëse. Aty ka aq shumë ngjarje dhe emra, që dëshmojnë per shumë e shumë sakrifica në mbrojtje të një popullsie të lashtë, atë të hebrejve të papërkulur, por të rrezikuar nga çfarosja.

Ky libër në fakt, më shumë se çdo gjë tjetër është një kthim nderi që Josef Jakoel dhe të bijat i bëjnë popullit shqiptar. Dhe shqiptarët që i mbrojtën ata njerëz të mirë kanë të drejtë të thonë:

"Kush nderon tjetrin, nderon veten"!

Për ta vënë në kontrast të plotë atë që kishte ngjarë në Shqipëri me izraelitët që jetonin këtu, me të tjerët që jetonin jashtë, madje edhe shumë afër nesh, në Korfuzin matanë detit, ai ia kushton librin:

"Motrës Eftihia, burrit të saj Rafo, djalit 5-vjeçar Niso, vajzës 2-vjeçare Lina, viktima të Hollokaustit: Nga Cefi."

Ndërkohe ai me familjen e tij qëndruan në Shqipëri dhe kaluan të sigurtë pa iu hyrë 'ferra në këmbë' gjatë tërë kohës së Hollokaustit. Këtë kontrast ai e jep në një pasazh të librit kur thotë:

"Jeta në Shqipëri kalonte e qetë e krejtësisht normale, sikur ato që ndodhnin në Evropë i përkisnin një bote

krejt tjetër, që nuk kishte asgjë të përbashkët me jetën e tyre".

Libri "Izraelitët në Shqipëri" i botuar me shumë sqimë nga Shtëpia Botuese "Çabej", përbën një momument të rrallë të një dëshmie të pashoqe në historinë tonë më të re. Në fillim lexuesi do të njihet me një hyrje të shkruar nga Shirley Cloyse DioGuardi, Këshilltare e Çështjeve Ballkanike në LQSHA në New York, si edhe përfshirjen e kongersmenëve amerikanë me origjinë hebraike, Tom Lantosh, Benjamin Gilman dhe Jerold Nadler. Më pas për biografinë e autorit Josef Jakoel, "Cefin", babain e saj të dashur, shkruan me shumë veneracion e bija, Feliçita. Ajo na jep një tablo të jetës në familjen izraelite të Jakoelëve dhe rolin që luante ai burrë mendjendritur, në

edukimin e tyre sa me ndjenjat dhe virtytet e popullit të vet aq edhe me dashurinë për Shqipërinë, atdheun e tyre të dytë.

Vitet që nga koha e Hollokaustit kishin kaluar në heshtjen mbytëse të diktaturës, nga frika e persekutimit. Për hir të vërtetës, për Jakoelët kjo nuk vinte për shkak të origjinës etnike, pasi antisemitizmi në Shqipëri nuk ekzistonte, por për shkak se gjyshi Rafael Jakoel, ishte i shpronësuar. Dhe ja ku vjen një ditë dhe Feliçita, kjo bijë e Jakoelëve në vitin 1990, viziton Izraelin, shkon në Jeruzalem dhe sheh Muzeumin e Holokaustit dhe Kopshtin e "Fisnikëve midis Kombeve" Yad Vashem. Ajo mëson nga këto muzeume për tmerrin që kishte përjetuar kombi i saj prej Holokaustit dhe e krahason atë me paqën dhe sigurinë që iu kishin

dhënë shqiptarët hebrejve në atë kohë. Ajo mediton në atë vend dhe thotë:

"Brenda vetes u ndjeva krenare!"

Por, krenaria e saj *venitet* kur sheh se nga populli shqiptar i cili kishte demonstruar Fisnikërinë më të Madhe midis Kombeve të tërë Evropës, as që figuronte aty fare!? Dhe aty ajo i vë një detyrë vetvetes:

"Ta bëjë këtë Histori të Lavdishme të njohur në tërë botën".

Gjatë vizitës së saj të parë, ajo dorëzon tërë emrat e hebrejve të Shqipërisë, të mbledhur nga i ati Josefi. Falë punës së këtyre dy njerëzve, Yad Vashem, i cili në vitin 1990 kishte vetëm një emër shqiptar, atë të Refik Veselit nga Kruja, i vendosur në vitin 1987, sot ka të gdhendur plot 75 emra të "Fisnikëve Shqiptarë

në mes të Kombeve". Jakoelët iniciuan edhe krijimin e Shoqatës Shqipëri – Izrael.

Josef Jakoel në këtë libër ka sjellë një evidencë të plotë ngjarjesh nga më të habitshmet sesi populli shqiptar i mbrojti izraelitët e vet, por edhe ata të huaj. Ai i jep përgjige edhe pyetjes se përse shqiptarët i mbrojtën hebrejtë? Përgjigjen e kësaj pyetje ai e gjen tek Kodi i lashtë i nderit të shqiptarit, tek Besa dhe Mikpritja dhe citon:

"Shpia e shqiptarit asht e Zotit dhe e Mikut"
"Po të hini miku në shpi, gjak me t'pasë do t'i thuash: Mirëserdhe"!
Në një prezantim për Besën Shqiptare në Institutin e Kërkimeve Hebraike YIVO, në

New York, një zonjë, nga salla, e cila kishte humbur tërë familjen nga Hollokausti më pyeti:

"Përse, përse e bëtë ju shqiptarët këtë, kur tërë Evropa e qytetëruar na vrau, na masakroi, na dorëzoi tek gjermanët, na dogjën në krematoriume, na zhdukën, na shkatërruan!?

Përgjigja ime ishte:

"Në Shqipëri nuk ekziston ligji i mos-kalimit të pragut të derës së oborrit ose "*trespassing*" siç i thonë amerikanët. Ekzison një ligj tjetër: Besa, Mikëpritja, Miku.

Një ndër gjërat e bukura që gjen njeriu në këtë libër është frymëzimi që ai sjell për ringjalljen dhe ruajtjen e gjuhës: Ai bën një paralele midis hebraishtes dhe shqipes kur thotë:

"Ringjallja e hebraishtes është një rast unik në historinë e filologjisë ku një "gjuhë e fjetur" ndër shekuj u shndrrua në një kohë të shkurtër në një gjuhë të gjallë dhe aktive" dhe shton:

"Kështu ndodhi edhe me gjuhën shqipe edhe ajo ishte varfëruar, e molepsur me huazime nga gjuhë të huaja që nuk iu bënte ballë kërkesave bashkëkohore. Punës i hyri Kristoforidhi dhe ajo punë vazhdon edhe sot."

Kur vjen fjala tek ngjarjet dhe faktet që paraqet vetë autori thotë:

"Ngjarjet në fjalë përmbajnë një dozë të tillë ndjenjash, lartësisht njerëzore, shpirtmadhësie, bujarie dhe guximi saqë duhet patjetër t'i bëhën të njohura botës. Faktet janë të vërteta, pa shtesa dhe zbukurime, pasi nuk kanë nevojë për to meqë flasin vetë".

Në një rrëfim tronditës për motrën e vet në fund të librit ai tregon sesi vetë familja e tij jetonte me brengën e tmerrshme të dhimbjes për humbjen e tërë familjes së saj të dorëzuar tek nazistët që nga Korfuzi.

Ai shton:

"Çdo izraelit që jetonte në Shqipëri dhe që kishte pasë të afërm jashtë Shqipërisë, kishte të njejtën brengë pasi të tërëve iu ndodhi që të afërmit t'u ishin ekzekutuar".

Pyetjes që shpesh bëhet nga të huajt sesa peshë kishte Shqipëria që mbrojti pesëqind, një mijë apo edhe dy tre mijë hebrej, kur në Evropë makina grirëse naziste eleminoi gjashtë milionë syresh, Josef Jakoel i përgjigjet tek citon Talmudin:

"Shpëtimi i një jete të vetme njerëzore është baras me shpëtimin e një bote të tërë".

Kur mëson për historitë e aq shumë hebrejve dhe shqiptarëve që i mbrojtën, mund të thuhet me plot gojën se, secila histori mund të përbëjë një libër shumë faqesh, më vete.

Në përfundim dua të jap një dëshmi krejt personale.

Kam pasur fatin ta njoh nga afër Kongresmenin amerikan me origjinë hebraike, Benjamin Gilman. Lidhja e tij me LQSHA dhe kontributi i tij i jashtëzakonshëm ndaj çështjes së Kosovës ishte i lidhur sa me politikën amerikane, aq edhe me ndjenjat e fuqishme që ai ushqente për popullin tonë. Kjo ishte e bazuar në këtë histori që Josef Jakoel i la trashëgim shqiptarëve,

izraelitëve dhe mbarë botës. Neve duhet të punojmë që ta bëjmë këtë histori sa më të njohur. Personalisht kam patur fatin që ta prezantoj historinë e Shpëtimit të Hebrejve në Shqipëri lidhur edhe me jetën e Ambasadorit Amerikan Herman Bernstein në Tiranë, në Ambasadën Shqiptare dhe atë Amerikane në Londër, në Sinagogën Pinner, në Kennedy School of Government në Harvard, në Akademitë Diplomatike në Vjenë, Gjenevë dhe Prishtinë, në Universitetin e Tiranës, Fondacionin "Ivanaj" si dhe në shumë institucione të tjera në Tiranë. Në fakt duke e bërë të njohur atë, ne shqiptarët e njohim edhe anën më të mirë të qënies tonë.

Norman Greshman, fotogarfi i njohur hebre – amerikan, në Filmin "Besa – Premtimi" - thotë:

"Shqiptarët nuk kanë aq shumë për të eksportuar, por ata kanë një produkt unik në botë:

BESËN SHQIPTARE"

Këtë produkt më mirë se kushdo e ka "përpunuar" për "treg" Josef Jakoel.

Ato çfarë përshkruhen në këtë libër përbëjnë një nga fenomenet më të bukura që na bën ne, shqiptarëve, krenarë përpara botës!

Mal Berisha



HERMAN BERNSTEIN

(1876 – 1935)

Journalist, Writer, And Diplomat

Albanian-American-Jewish Relations:

Contributions of U.S. Ambassador to Albania, Herman Bernstein (1876-1935)

By Mal Berisha

RUTH GAY SEMINAR IN JEWISH STUDIES
YIVO Institute for Jewish Research
December 14, 2014

This presentation is based on the documents generously offered by the YIVO Institute for Jewish Research

Prezantim në YIVO Institute of Jewish Studies, 14 Dhjetor 2014, New York.

DIELLI

No. 5157 BOSTON, MASS., FRIDAY, MARCH 21, 1930 VOL. XXII 22ND YEAR

EKSELENCA E TIJ MINISTRI I RI I AMERIKES NE SHQIPERI

Botojme, ne vijen e pare, fytyren e E. T. Zotit Herman Bernstein, Ministrit te Shtéteve te Bashkúara prane bohorit te Shqiperise, dhe te Zonjes Bernstein.—Ne vijen e dyte, duke nisur nga krahu i mangjer i kendónjesit, Miss Dorothy Bernstein, Mr. David Bernstein, Miss Violet Bernstein.

Faik Konica dhe Herman Bernstein

ERICKSON E BERNSTEIN, DY AMERIKANË QË NA DONIN ME SHPIRT

Shkruar nga Miho Gjini[1], Mjeshtër i Madh, Kritik arti, teatri e letërsie.

Botuar në Gazetën SHEKULLI, Dt. 26 Korrik 2018

[1] *Mjeshtri i Madh Miho Gjini, është një ndër kritikët më të shquar të letërsisë dhe të teatrit shqiptar, autor i mëse 23 veprave kritike, letrare, dramaturgjike dhe artistike. Për shkak të ideve demokratike në artin dramatik, ai u dënua nga diktatura komuniste në vitin 1975 dhe vuajti në burgjet më të vështira politke dhe në internime deri në vitin 1991, kur Diktatura ra në Shqipëri.*





Duke lexuar dy monografi të shkruara nga ish Ambasadori shqiptar në Britaninë e Madhe dhe Irlandë, Z. Mal Berisha, njëra për misionarin Erickson dhe tjetra për diplomatin Berstein, për jetën e punën e tyre të jashtzakonshme si diplomatë të dërguar nga kontinenti i largët, në

periudhat më të vështira të popullit tonë, bindesh menjëherë se Amerika ishte dhe mbeti miku ynë më i madh e më i vyer, përsa i përket ekzistencës si komb, lirisë e pavarsisë. Ne njihemi kështu me Charles Telford Erickson (1867-1966) që shërbeu 30 vjet në Shqipëri dhe Herman Bernstein (1876-1935) që shërbeu në Shqipëri në kohën e Mbretërsë së Zogut, 1930-1933.

Erickson

Qysh kur errdhi në Korçë, më 8 shtator 1908, nga ana e Manastirit, ai kishte thirrur: "Tu ngjate jeta Shqipëri!", pasi kishte udhëtuar me det, me tokë, me makina të tipit të vjetër, me karroca e me kuaj dhe do të mbetej këtu për 32 vjet me radhë, i dashuruar me këtë vend, me

popullin e saj, me privacionet e luftrat, me gjithçka që ishte shqiptare, duke lënë këtu edhe shpirtin e vet. Bëmat e tij janë të jashtzakonshme, sikundër edhe vuajtjet, bashkë me familjen, në çdo cep të Shqiperisë, për të shpërndarë dritë, arsim e fanarët e lirisë. E do të mbetej një vepër kryesisht e tij: Shkolla Bujqësore e Kavajës (për djem e vajza), e themeluar në vitin1923, si një nga monumentet e para të arsimit profesional tonin në nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja e trashëguar. "Këtu – i shkruante ai një miku të tij në Amerikë, – ka një egërsi dhe një liri që na rrethon, e cila e bën këtë vend të ndryshëm nga krejt bota tjetër, e veçanërisht nga jeta konvecionale në atdheun tonë!".

Rrallë mund të kete ndodhur që udhëtarë të huaj, turistë, njerëz gjithfarësh të të gjitha sferave, të jenë shprehur në trajta superlative për vendin tonë të raskapitur nga luftrat e pandërprera, në krahasim me atdheun e tyre! Dhe që më pastaj, ta ndanin jetën e tyre, kafshatën e bukës, vuajtjet, ëndrrat dhe vdekjen me popullin tonë e të bëheshin shqiptarë deri në palcën e trupit! Se Ericksoni ngjan me një personazh tragjik, pasi pranoi të njejtat rrethana dramatike të njësuara me ne, përballë lakmive turke, serbe, malazeze, italiane e greke, duke

provuar edhe torturën, burgimin, sëmundjet, vdekjen e të birit e arratisjen në mal, marrosjen e së shoqes nga kushtet e vështira të jetesës e sa e sa të tjera. Dhe, kur diplomatët e vendit të tij kërkonin mbrojtjen e personalitetit të tij si qytetar amerikan, do të merrnin këtë pergjigje nga autoritetet turke: "Ai është Shqiptar, flet e vuan si Shqiptar"! E do të jetë deri në fund të jetës së tij si i tillë, një amerikano-shqiptar që hyjnizon shpirtin, virtytet, krenarinë e sakrificat e shenjtëruara të shqiptarëve si komb.

Ky burrë stoik si qëmoti, i paepur si karakter, është dekoruar në v. 1931 me "Urdhërin e Skënderbeut" dhe qe mik nderi i Mbretit Zog, qe delegati zyrtar i "Vatrës" në Amerikë në Konferencën e San Franciskos në vitin 1945, shkroi 5 vepra për Shqipërinë me titull

“Shqipëria – Enigma e Ballkanit” dhe, kur do të largohej për në “botën tjetër”, patrioti shqiptaro-amerikan Qerim Panariti do të shkruante: “Ericksoni ishte një burrë gjenial, i shumanshëm, predikues, misionar, diplomat, edukator dhe poet, i cili ia kushtoi jetën Shqipërisë dhe popullit të saj nga errësira mesjetare”.

Herman Bernstein

Ky ishte personaliteti tjetër i shquar që dërgoi Amerika në ditë të vështira për Shqipërinë, kur gjitonët e fuqi të tjera më të mëdha “donin ta shqyenin e coptonin” nga faqja e dheut e do të mbetet si Ambasadori më i shquar i ShBA në vendin tonë i cili shërbeu nga viti 1930-1933. Hebre nga origjina, i lindur në Lituani dhe i

natyralizuar si shtetas amerikan, ai zotëronte 7 gjuhë të huaja, ishte shkrimtar, poet e kritik letrar, autor i 14 veprave origjinale dhe i shumë studimeve për Leon Tolstoin, Çehovin, Andrejevin, Bernard Shoun dhe, mbi të gjitha të tjerat, mik i afërt i tre presidentave amerikanë dhe i shkencëtarit më të shquar të botës në kohën e tij Albert Ajnshtajn. Ai përktheu nga gjermanishtja në anglisht dramën e Aleksandër Moisiut "I burgosuri" kushtuar Napoleon Bonapartit për të përmendur vetëm disa prej veprave të tij. Ai vërtetë ndenji në këtë truall tre vite, por ato mbetën në kujtesë sa për tre shekuj të tërë!

Kur Ericksoni do të themelonte Shkollën Bujqësore të Kavajës, ishte pikërisht Bernstein ai që do të përshëndeste këtë ngjarje të madhe

për arsimin tonë. Ai do të bëhej mik i afërt i Mbretit Zog e do të jetonte, punonte e do të shkruante për të studimin më adekuat, do të lidhej menjëherë me personalitete të tjera të Shqipërisë, si At Gjergj Fishtën, Nolin, Konicën, Lef Nosin e do të kishte korespondencë të vazhdueshme me Aleksandër Moisiun. Do të gëzonte edhe ai prej Mbretit Zog "Urdhërin e Skënderbeut". Kemi prej tij një studim të thelluar për Skënderbeun, një dramë origjinale të përkthyer të Moisiut dhe bëhet avokat i madh i popullit tonë në shumë forume ndërkombtare. Autori shkruan se Bernstein 'ishte njeri universal…dhe se emri i tij u fsheh per 46 vjet të sundimit të egër komunist në Shqipëri, por ai përfaqësoi këtu popullin amerikan e personalisht miqësinë e pakursyer të

tre pesidentëve të shquar amerikanë: Roosvelt, Wilson e Hoover, të cliët ishin edhe miqtë e tij personal.

Në një udhë bashkë me ne…

Që të dy këta njerëz të mrekullueshëm bënë rrugëtime të pafundme nëpër Shqipëri, udhë e pa udhë, në mot të keq të natyrës e të politikës, ditën e natën, si dy martirë që si tremb as vdekja, ngado që vinte ajo. Ericksoni njohu edhe "udhën universale të zemrave të shqiptarëve", po edhe vuajtjet e kolerës. E merrte udhën edhe i vetëm, me këmbë, kur papritur shqiptari i ofronte edhe kalin e vetëm që të udhëtonte i qetë, rrugë e pa rrugë. E kur i vdiq fëmija nga e njëjta sëmundje e mallkuar,

do t'i vinte për ta ngushëlluar i gjithë qyteti i Elbasanit, për t'i lehtësuar dhimbjen. PIANO.

Bernstein-i, që ishte edhe shkrimtar, sodiste me kërshëri rrugicat e Tiranës, endej nëpër pazarin e vjetër e vajti me këmbë deri në Shijon, nga Rruga e Qafë Krrabës, për të dëgjuar një meshë në Kishën e Shën Gjon Vladimirit. "Kam patur kënaqësinë, - shkruante Ai, - të udhëtoj shumë në vendin tuaj të bukur dhe kam parë me sytë e mi edhe gëzimin, edhe keqardhjen. Kam parë njerëz të padjallëzuar, të thjeshtë, shumë punëtorë, paqësorë, dashamirës dhe të këndshëm, të pajisur me tipare dhe karaktere fisnike..." Bernsteini do të ndjejë edhe fisnikërinë shqiptare në mbrojtje të njerëzve të besimit të vet, të atyre hebrejve që po persekutoheshin barbarisht nepër Evropë por

që gjetën strehë e mbrojtje në vendin tonë…Prania e këtij diplomati amerikan me prejardhje hebraike është akoma një dëshmi e bujarisë shqiptare, kur Profesor Scarlett Epstein, edhe ajo hebreje, shkruante se:" Unë jam gjallë në sajë të bujarisë shqiptare".

Shqiptarizma

Që të dy këta emisarë të lirisë, kishin të njejtin ideal, në kohë krejt të ndyshme: se shqiptarizma mund të fuqizohet, brenda e jashtë këtij trualli, përmes përhapjes së dijes dhe shkollës shqipe, kundër errësirës, prapambetjes feudale e përçarjeve të huaja, duke sensibilizuar kudo forcat progresive në Shqipëri e kudo në botë. Ericksoni njihej e forcon miqësinë me Lef Nosin e Gjon Koliakën në Elbasan e Kavajë,

me motrat Sevasti e Parashqevi Qirjazi në Korcë, me Kristo Dakon në Durrës dhe me Luigj Gurakuqin e Sotir Pecin e sapo kthyer nga jashtë. Qysh në vitin 1911 Ericksoni kërkonte që të vendosej gjuha shqipe si gjuhë zyrtare në vilajetet e Shkodrës, Korçës, Manastirit e Janinës "të cilat, - nënvizonte ai, përbëheshin në shumicën absolute nga shqiptarë…". Të njejtat ideale do të vazhdonte të forconte 20 e ca vite më mbrapa në Shqiperi e jashtë saj Bernsteini, duke vendosur po në të njejtin rrafsh Amerikën, Izraelin dhe Shqipërinë, shpirtërisht e politikisht, - gjë për të cilën do ta anatemonin ashpër qarqet e huaja fashiste se "po i tejkalonte kufijtë e punës së një ambasadori!…"

Brenda e jashtë Europës (?!)

Dhe kështu, që të dy këta amerikanë, do të ndesheshin me çështjen më paradoksale të të gjitha kohërave, se vendi më i lashtë i Europës do të qëndronte artificialisht jashtë saj! Një absurditet, që do t'ia kalonte çdo hamendje e që do të vazhdonte artificialisht deri në ditët e sotme …. Ishte ky Erickson, që në vitin 1913, në nje gazetë Londineze do të shkruante se si " një popull superior, ishte paraqitur mbrapsht në mënyrën më të qëllimshme dhe te padrejtë në pjesën tjetër të Europës..", duke u shprehur më tej kundra Traktatit të Fshehtë të Londrës. Së toku edhe me Zonjën Edith Durham, do t'i përkushtoheshin çështjes shqiptare kundër pretendimeve territoriale të serbëve, bullgarëve,

malazezëve, grekëve, italianëve etj. dhe propagandës së tyre shoviniste se "shqiptarët janë gjysme të egër", duke u thënë atyre me zë të lartë e të fortë se kanë të bëjnë me një popull të qetë e të mrekullueshëm, të cilët "i kanë dhënë përherë individualitete të shkëlqyera Greqisë së Lashtë e asaj moderne, Perandorisë Bizantine dhe asaj Turke…"(Hequate), si edhe Romës, Spanjës, Gjermanisë e më tej .Dijetarë të huaj kanë nënvizuar enkas se "Shqiptari është një aristokrat, një njeri i lirisë dhe fisnik "(Rene Pinon), "jashtë ata janë luftëtarët e paepur të Aleksandrit, të Pirros, Dioklecianit, Skënderbeut…." (Historie de Turke, Lavalle). Me cilësinë e një studjuesi të mirëfilltë, të një publiçisti të shquar e të një diplomati energjik, Bernsteini, pasi e shkeli me këmb tokën

shqiptare, pasi njohu mirë historinë e lashtë e të re, si edhe shpirtin e këtyre njerëzve, e quan Shqipërinë "tokë të panjohur europiane…, cep i fundit i pazbuluar i Europës Juglindore…i banuar prej një race të lashtë e të guximshme…, me toleranca fetare…, një popull tragjik, por një racë heroike…tokë e harruar e Europës!"

Po ky ambasador, nëpërmjet hulumtimeve të diplomatit tonë Mal Berisha, do të sjellë përpara opinionit publik shqiptar e atij botëror edhe qëndrimin e Mbretit Zog ndaj kësaj çështjeje të përjetshme, me intonacione teatrale absurde se, që më 17 korrik të vitit 1930, ai do të deklarohej "për një bashkim shteti europian, (që) vështirë se mund ta merrnin si çështje serioze… (dhe

që) për një kohë të gjatë do të mbetet veçse një ëndërr, një ideal i largët!"

Nëpër dyert e kancelarive të larta

Dhe historia zhgenjyese me Europen do të zgjaste për më shumë se një shekull, si një ëndërr e mirë dhe e keqe bashkë…Mandej kishte edhe sharrje të rënda për të, me fjalë që "si ngre kandari". Por vetë populli do t'ia merrte një kënge tjetër" "Mbahu nëno, mos ki frikë, se ke djemtë n'Amerikë"! Prandaj, Amerikani Erickson, që e nuhati këtë punë që në vitin 1908, "jepte e merrte" me Amerikën, jo vetem me bijtë e Shqipërisë atje, por edhe me qeveritarët e atjeshëm deri tek presidentët e saj. Po kështu bëri edhe amerikani tjetër Bernstein

qe “s’la gur pa lëvizur” që Shqipëria të mos kolonizohej.

Kundër idesë se shqiptarët “janëdele pa çoban” dhe rrezikut të coptimit të metejshëm, me një shtet të pavarur, ata këmbngulnin e kërkonin pranë kancelarisë së vendit të tyre të madh për ta shpëtuar Shqipërinë nga kaosi, para e pas luftrave ballkanike e botërore. Nëpër faqet e këtyre librave do të gje nden episode rrënqethëse, kur fati i vendit tonë do të “varej në fije të perit”, por që do të shfaqej në horizont një president Amerikan, i cili më 1919-ën, si Willson, do të thoshte në Konferencën e Paqës në Paris: “Të bëjmë një luftë për t’i dhënë fund luftës!”. Dhe, kur Ai do të mësonte prej mikut e të dërguarit të tij në Shqipëri se çfarë po ndodhte aty, për ta “shqyer si qentë!”,

do të thoshte botërisht: ”As unë, e as populli Amerikan, kurrë nuk do të pranojmë që populli shqiptar, i cili ka luftuar dy mijë vjet për lirinë e tij, të sakrifikohet për hir të ambicjeve politike të fqinjëve të vet”.

E do të ishte po ky Erickson që do të përfaqësonte Shqipërinë me 1920-en, si i deleguar i shtetit shqiptar në ShBA. Ai do të bënte gjithçka që Shqipëria të njihej në mbarë botën, për t’u kthyer dy vite më pas si diplomat amerikan në Shqipëri. Po edhe pas luftës së Dyte Botërore, në vitin 1945, Ericksoni, si të ishte tashmë një shqiptar i vërtetë, do të perfaqësonte “Vatrën” e Amerikës në Konferencën e San Franciskos, për të thënë përsëri me zë të lartë se:” Shqipëria e përgjakur dhe e shkatërruar nga lufta është lënë jashtë

derës!”. Diplomati i dytë amerikan Bernstein, edhe pse nuk qëndroi më tepër së tre vite në Shqipëri, intensiteti i veprimtarive të tij jashtë saj, vazhdoi ngado e kudo ku i shkonte fjala, deri sa dha frymën e fundit Një gazetar i asaj kohe shkruante se “prapa emrit të Bernstenit fshihet e gjithë Amerika”. Ai ishte, sikundër shprehet autori i këtyre librave, “Një avokat i madh i vendit tonë të vogël”. Dhe fjalën e tij do ta dëgjonin e vlerësonin të tre miqtë e tij më me vlerë, në kohë të ndryshme, presidentet Theodore Roosvelt, Woodrow Wilson dhe Herbert Hoover.

Midis Letërsisë e Publicistikës

Nuk kisha lexuar më parë libra të tillë, të cilët qëndrojnë bukur midis letërsisë e publiçistikës e

ku, si politika bashkëkohore, ashtu edhe diplomacia thuajse "burojnë" pastër, bindshëm, në trajtat më tërheqëse dhe me kompetencën që ka vlera e diplomacisë dhe e politikës. Ndofta është hulumtimi i thelluar dhe i shumanshëm i dokumentacioneve arshivore, ndofta vërtetësia e forca bindëse e figurave që përshkruan në korelacion me kohën, po edhe stili i të shprehurit gjuhësor, larg frazeologjisë stereotipe. Po janë edhe libra krejt të ndryshëm: Ai për Ericksonin i ngjan më tepër një romani, ku figura kryesore ka pamjen e një heroi origjinal që niset për të vuajtur, midis një populli, sa të varfër, aq edhe luftarak, duke u shndërruar vetiu në një personazh tragjik, bile në një hero të dimensioneve të mëdha, me shpirt të madh e stoik, që del nga vetia e u

përket të gjithëve. Ndërsa libri për Bernstenin është i ndarë në dy pjesë dhe ku fryma letrare, do t'ia lerë vendin analizave të diplomacisë e të politikës, brenda e jashtë…Autori Mal Berisha, është këtu brenda fushës së tij të diplomacisë, po është edhe brenda vetes, si njeri, duke shprehur kështu harmoninë e këtyre njerëzve që dalin edhe jashtë kohës së tyre, për vlerat gjeniale, të të dy popujve miq, të Amerikës e të Shqipërisë, duke rezonuar njësoj. Dhe, per të arritur deri këtu i duhej të bëhej edhe një "rrëmihes" i pashoq i arshivave të Londrës, Uashingtonit, Yales e New Jorkut, të Ankarasë e të Stambollit, duke gjurmuar jetën e veprimtarinë e këtyre dy amerikanëve të shquar, burra shteti dinjitozë, ministra të devotshëm, njëherësh shkrimtarë e poetë, përkushtimi e

dashuria e të cilëve ndërthurret midis vendasve ku bujtën dhe shtetit të tyre të madh.

Në një kryeqytet të Europes, ku kam jetuar e punuar nga halli i mbijetesës, kam njohur (midis ambasadorësh të përkushtuar , edhe ndonjë syresh "jashtë loje", të cilin e gjeje më tepër kudo ku "delte tym e kërciste daullja bym!", çakerqejf, qejfpaprishur e punëpabitisur, ndërsa Mal Berishen (që vitet e fundit ka hequr jo pak edhe nga mbiemeri qe ka), i dolën thinjat në kokë para kohe, duke qëndruar me korrektësi në krye të detyrës se vet, si i dërguari i një shteti të vogël në një nga shtetet më të mëdhenj e më të fuqishm të botës, që e perfundoi misionin e vet me dinjitet, i furosur me veprimtari diplomatike, kulturore e studimore, midis të cilave shquhen edhe këto dy monografi

diplomatësh të shquar e njerëzish të jashtzakonshëm.

LIBËR PËR NJË MENDJENDRITUR

Gazeta shqiptare 05.01.2018

Nga MONIKA STAFA

Me shkas nga libri "Herman Bernstein, ambasador i SHBA-së në Shqipëri (1930-1933), i M. Berishës

"Vendi mban një pozitë të rëndësishme në Adriatik. Në Shqipëri, edhe Lindja edhe Perëndimi i rrudhin krahët, si në pak vende të tjera…Mikpritja proverbiale dhe sensi i nderit nuk janë përkeqësuar në procesin e marshimit të shpejtë të nderit drejt

modernizimit. Turistët, vëzhgues të skenave të habitshme dhe shumë të bukura të kostumeve të veçanta, të gjitha të ndryshme nga njëra–tjetra do të zbulojnë këtë tokë të panjohur europiane. Nëse ata e vonojnë vizitën e tyre në Shqipëri, atëherë do të jetë tepër vonë. Shumë prej gjërave më të magjishme të Shqipërisë janë në zhdukje…"

Herman Bernstein, ambasador i SHBA-së, Tiranë, (1930-1933)

Kishte kohë që 'dalldia e madhe mediatike' e baltës që i hidhej vendit tim si rrallë herë më parë kaq publikisht, prej disa vitesh, nuk më bënte më përshtypje e që këtej gjithçka që vinte përmes kësi burimesh, e justifikonte indiferencën time dhe jo vetëm ndaj të tillë lukunie ujqërish që vetëm këtij vendi nuk i

përkasin për gjak e shpirt. Jo se jam shumë e rezervuar në përshtypjet e mia ndaj 'zërave' të tillë, por, sepse ajo gjendje e neveritshme që të sjell në mendje këtë ndjesi është bërë e përditshme dhe tashmë mënyrë jetese. Në një vend ku mungon kultura e refuzimit të së keqes, nuk ka si ndodh ndryshe; në një vend ku njeriu nuk bën përpjekje më të provojë se nuk është mposhtur nga e keqja, madje kënaqet duke gjetur një provë se ka dhe të tjerë si ai; në një vend ku askush nuk guxon të shqiptojë se jo çdo refuzim është i keq, madje heshtje edhe atje ku ligësia përton të ngrejë sytë kur e sheh se kontrollon gjithçka. Askush nuk do ta kuptonte vërtet se shqiptarët janë një popull që nuk mund ta marrësh për budalla, si kemi dëgjuar kryeministrin e vendit ta cilësojë pothuaj në çdo

dalje publike. Në të shumtën e herës, edhe vetë shqiptari nuk e beson këtë që i pari i vendit të tij, e përsërit në çdo 'kuvend'. Dhe arsyet janë të shumta. E vërteta është se ajo që i huton ata në këtë pasthirrmë të çuditshme të liderit të kombit të vet, nuk ka rëndësi nëse është e sinqertë apo jo, është fakti që ata nuk besojnë më, në asgjë çfarë ndodh e çfarë flitet në mjedisin e tyre të vogël. Dhe që këtej u lind një e drejtë; e drejta për të menduar. Nuk kisha perceptim tjetër pas leximit me një frymë të librit me titull "Herman Bernstein, ambasador i SHBA-së në Mbretërinë Shqiptare 1930-1935" me autor Mal Berishën, teksa sillja ndër mend se prej çfarë thellësish të errëta të jetës, ku sundojnë vesi, krimi dhe mizerabiliteti i shtyn njerëzit e të njëjtit komb të hedhin baltë, baltë

dhe baltë pangopësisht mbi vendin e tyre, kundërshtarin apo dhe të ngjashmin e tyre.

Si u njoha me Herman Bernstein?

Teksa studioja temën time të doktoraturës "Mbi hebrenjtë në Shqipëri, 1933- 1946" kisha ndeshur rrugës së kërkimit tim shkencor dhjetëra e qindra emra politikanësh dhe diplomatësh po aq dhe gazetarësh të huaj që kishin shkruar për Shqipërinë, e kjo jo si një detyrë ndaj një vendi që u ka ofruar një shërbim të caktuar, por thjesht nga ajo ndjesia që çdo njeri ka, kur dëshiron diçka ta rrëfejë e ta lërë si një pasuri kujtese më pas. Me shënimet e diplomatit amerikan në Shqipëri, Herman Bernstein, isha ndeshur vite më parë teksa bisedoja me një tjetër diplomat në Tiranë,

idealistin e pandreqshëm në bindjet dhe mendimet e tij, mikun John Withers II, i cili më kish bërë të njohur pikërisht pasionin e tij të të shkruarit ku që këtej kisha mësuar edhe për punën e tij, si gazetar dhe diplomat (1930-1933), në njohjen dhe promovimin e mbretërisë shqiptare në qarqet perëndimore të Europës, problemeve me të cilat ajo po përballej, por dhe çështjeve të ndryshme si mbrojtja e hebrenjve, promovimi i Shqipërisë si një vend turistik etj., si këto. Do më mjaftonte kaq për ta futur në agjendë kërkimesh emrin e tij të njohur ndërkombëtarisht, edhe si gazetar i shquar investigativ.

Kush është Herman Bernstein?

Herman Bernstein ka botuar 14 vepra e fatmirësisht të gjitha mund të gjenden të ribotuara edhe sot. Vetëm veprat e përkthyera nga ai, janë 17 e të gjitha kryevepra të autorëve të mëdhenj. Në këtë libër ambasadori Berisha nuk ka përfshirë vetëm periudhën e jetës së Herman Bernstein në Shqipëri, por aty duket se gjendet dhe densiteti i jetës së tij paraprirëse intelektuale. Diplomati amerikan Herman Bernstein, nuk ishte një njeri i zakonshëm, ai ishte një potencial mendimi kritik dhe dijetar i disa disiplinave të ndryshme filozofike e psikologjike, të cilat i njihte për shkak të dëshirës për informacion e dije. Në një moment të përshkrimit të jetës së tij ai i shpjegon kështu

burimet e njohurive të tij për botën dhe universin: *'...i kam përvetsuar teoritë shkencore më moderne nga Metchnikoff. Kam diskutuar për fenë dhe për artin me Leon Tolstoin. Principet e filozofisë moderne i përfitova nga Henri Bergson, diplomacinë botërore dhe çështjet ruse nga Konti Witte dhe Maksim Kovalovski, teorinë e artit e mësova nga August* Rodin, *shtetformimin nga Theodor* Roosevelt *dhe Woodrow Wilson, mbrojtjen e të drejtave të grave nga Havelock Ellis, imperializmin gjerman nga Hans Delbruck, literaturën dhe pacifizmin nga Georg Brandes, politikën e luftës dhe të paqes së Vatikanit nga Papa Bendedikti XV, sionizmin nga Weizmann dhe Anjshtajn, revolucionin rus nga Trocki, liberalizmin britanik nga Lordi Robert Cecil dhe gjithçka tjetër nga George Bernard Shaw'.*

Bernstein dhe Shqipëria

Të vjen çudi se si një ambasador amerikan i atyre viteve, i ngarkuar me punë në një mision diplomatik, në një vend të vogël si Shqipëria, edhe pse nën masat e rrepta të një protokolli, vendos t'i thyejë ato duke e nisur ditën e parë të punës së tij, me përshkrimin mbi natyrën e magjishme në qiellin shqiptar dhe çuditë e saj të ngatërruara. Hulumtimet rreth Bernstein në çdo faqe të librit që rrëshqet duket se janë një lloj lundrimi në një oqean dijesh, që prek tërthorazi jo vetëm botën hebraike në të katër anët e saj, por dhe skajet e vetë kulturës dhe historisë së kohërave tona. Studimi i jetës së tij, në syrin e mprehtë të një diplomati si Mal Berisha, përbën në vetvete një sipërmarrje shumëplanëshe e

tepër virtuoze. Kur lexon këtë libër kupton sa i rrallë e po aq i admirueshëm mbetet fakti se sa shumë mund të bëjë njeriu gjatë një jete jo aq të gjatë, sa ajo e Bernstein. Mal Berisha ka hulumtuar në dhjetëra udhëtime të gjata ndërkontinentale të tij, në ato kushtet e lëvizjes së ngadalshme të kohës, duke kërkuar vullnetshëm dritën dhe ndriçimin që një studiues serioz dhe atdhedashës do të nxjerrë në pah tek bashkëkombësit e vet. Bernstein cilësohet si një mik i madh i kulturës shqiptare. Ai gëzoi respektin dhe simpatinë e intelektualëve shqiptarë të kohës, si At Gjergj Fishta, Aleksandër Moisiu, Lef Nosi, etj. Edhe pse Shqipëria paraqitej si një vend i vogël, emërimi i Herman Bernstein ishte një vlerësim shumë i madh politik që i jepej dikujt, pjesëtar i

kësaj bashkësie në historinë e Amerikës. Se sa të afërta dhe konfidenciale ishin marrëdhëniet e Bernsteinit me mbretin A. Zog dëshmohet dhe në disa raporte dërguar Departamentit të Shtetit ku ndër të tjera A. Zogu i përcillte atij në një bisedë shqetësimin se Shqipëria është një vend i vogël. Nuk kam kohë për të humbur. Një prej problemeve më të mëdha që kam,-cilësonte mbreti shqiptar më tej, – është të gjej njerëz, të cilëve duhet t'u delegoj disa prej punëve të mia të rëndësishme. Ne vuajmë për njerëz të aftë dhe të përgjegjshëm, -pat mbyllur ai bashkëbisedimin me trishtim.

Si ka mundësi që një hebre lituanezo- amerikan, kaq i famshëm për polemikat e tij me njërin nga njerëzit më të fuqishëm të botës, industrialistin Henry Ford rreth çështjes hebraike dhe

antisemitizmit do të caktohej në Shqipëri? Si është e mundur që në Shqipërinë e vogël dhe aq pa peshë në politikën globale do t'i shërbente Amerikës gazetari që mbuloi Revolucionin e Tetorit, e sa e sa ngjarje të mëdha që i kishin ndodhur njerëzimit në fillim të shek. të 20-të deri në vitin 1930 kur ai filloi punë si Ministër Fuqiplotë i SHBA-ve në Tiranë? E kjo ndoshta për të vetmen arsye; Shqipëria kish hyrë në agjendën diplomatike të SHBA-së, që nga momenti kur presidenti Wilson botoi deklaratën e tij në France Press, më 24.IV.1919 në të cilën i priste udhën copëtimit të Shqipërisë nga fuqitë europiane. Një personalitet i tillë, shkruan autori i librit në një kontekst shqiptar mbetet promovim i Shqipërisë, pasi ai përfaqëson dikë që ka përmasa universale. Ky

është dhe qëllimi dhe misioni i veprës sime - shpjegon më tej Mal Berisha: '…të zbulohet Shqipëria dhe shqiptarët siç e kanë parë njerëz të tillë të mëdhenj'. Ky quhet ndryshe dhe 'pushteti i butë' i kombeve të vegjël në marrëdhëniet ndërkombëtare, teoria moderne e njohjes së kombeve të vegjël nëpërmjet pafundësisë universale të vlerave shpirtërore, kulturore historike të njerëzimit dhe mjeti për promovimin e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo teori e përpunuar prej Joseph Nay Jr, konfirmon se edhe kombe të vegjël, si Shqipëria nëse dinë të përdorin mirë trashëgiminë e tyre shpirtërore, kulturore dhe historike mund të bëhen interesante përpara kombeve të tjera dhe të arrijnë synimet e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo është dhe

arsyeja përse presidenti amerikan Herbert Hoover, caktoi në Shqipëri si përfaqësues të tij një nga njerëzit me përvojën më të pasur me një emër të madh në gazetari, politikë, art e kulturë, një intelektual *par excellence*, një luftëtar të paepur të një çështjeje të madhe, jo vetëm për një komb, por për të gjithë njerëzimin: hebraizmin.

Bernstein dhe çështja e mbrojtjes së hebrenjve në Shqipëri.

Herman Bernstein kishte një ndikim të jashtëzakonshëm te lobi hebraik në SHBA, i cili ka luajtur përherë një rol shumë të rëndësishëm në zgjedhjen e presidentëve amerikanë të paktën prej asaj periudhe. Duhet thënë se

Amerika e atëhershme nuk ishte aspak ajo e sotmja ku respektohen të drejtat e bashkësive të ndryshme. Gjurmët e antisemitizmit në Europë kishin filluar të shfaqeshin dukshëm. Edhe Amerika vetë, edhe pse vend i formuar nga emigrantët pati dhënë shembuj që nuk e bëjnë të ndihet mirë në raport me hebrenjtë e asaj kohe. Bernstein ishte i njohur si mbrojtës i paepur i çështjes së hebraizmit dhe ndërtimit të një shteti izraelit bashkë me njerëz të shquar nga fora hebraike, përfshirë dhe shkencëtarin e madh A. Anjshtain. Ai mendonte të hapte një korridor mbrojtës për hebrenjtë e Europës të kërcënuar nga nazizmi, duke i vendosur ata diku në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë. Herman Bernstein është i pari titullar i lartë hebre që shfrytëzoi rrugën e diplomacisë, si një

mënyrë për të shpëtuar popullin e tij në rrezik dhe për t'i shërbyer me devotshmëri vendit që e mbështeste aq shumë këtë iniciativë. Diskutimet e Bernstein me Mbretin Zog në lidhje me mundësinë e vendosjes së një numri hebrenjsh nga Europa në Shqipëri, kanë pasur efektin e tyre në mbrojtjen e hebrenjve para dhe gjatë pushtimit italian dhe gjerman. Mbreti Zog u dha një porosi misioneve konsullore shqiptare në Europë, që të pajisnin me viza ata hebrenj të Europës, të cilët e shikonin Shqipërinë si mundësi shpëtimi. Kjo është dëshmia më e qartë e asaj vepre humane që arriti ambasadori Herman Bernstein me mbretin Zog në shpëtimin e hebrenjve, bazuar në ndjenja njerëzore të bashkëjetesës ndërfetare si një

model unik e shprehës i vlerave universale njerëzore.

Arsyeja që e thellonte më shumë besimin e tij për të krijuar këtë korridor shpëtimi për kombin e tij duke u investuar madje edhe personalisht në marrëdhënie ndërpersonale me Mbretin Zog ishte pikërisht bashkëjetesa e shqiptarëve me hebrenjtë prej shekujsh. Duke qenë një kërkues ambicioz dhe me një vullnet të hekurt, ish gazetari i njohur kish grumbulluar nëpër qytetet e rëndësishme shqiptare mjaft të dhëna historike që vërtetonin këto gjurmë që në kristianizëm. Ja çfarë shkruan Apostol Kotani në librin e tij "Hebrenjtë në trojet shqiptare" mbi kërkimet e ambasadorit amerikan H. Bernstein; '…patriku i kishës ortodokse shqiptare, Visarioni, i kishte folur për një

vendbanim të madh hebrenjsh shumë vite përpara, si dhe për një ndërtesë të madhe me yllin e Davidit që kish qenë sinagogë dhe më vonë u përdor nga turqit si han'. Kotani thekson më tej se Herman Bernstein shkruante se kjo pjesë e Elbasanit ish njohur si qendër banimi e hebrenjve dhe se ortodoksët që banonin aty mbanin emra biblikë si Abraham, Isak, Jakov, Moise, etj. H. Bernsteinit, Visarioni i kishte folur me entuziazëm për ndihmesën e dhënë prej hebrenjve në zhvillimin e qytetërimit duke denoncuar madje edhe persekutimet kundra tyre, në vendet e tjera. Ai përmendi dhe disa pjesë nga testamenti i vjetër hebraik duke hedhur idenë se Patriku Visarion mund të ishte me prejardhje hebraike, prej atij grupi që jetonin prej vitesh në Shqipëri. Sipas diplomatit

amerikan, nënvizon A. Kotani, në arkivat e qytetit të Elbasanit u gjet një dokument i vjetër i shkruar me dorë mbajtur nga një turk, rreth 200 vjet përpara, i cili bënte fjalë për tregtarë të shumtë hebrenjsh që ishin përpjekur të shkelnin ligjet turke dhe ishin ndëshkuar prej tyre. Ndër të tjera, diplomati amerikan Herman Bernstein shkruante se kishte zbuluar në një botim të vitit 1611 në Gjermani se një bashkësi e madhe hebrenjsh ka ekzistuar në Shqipëri gjatë shekujve XV-XVI. Sipas tij në këtë libër shkruhej se mijëra hebrenj patën gjetur vendbanim në qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë si Lezha, Durrësi, Vlora, Shkodra, Kruja, Berati, Dibra e Danja. Ata ishin hebrenj të ikur nga Ankona në kohën e Papa Palit IV, 1476. Dhe, për fatin e mirë të atyre, që u

vendosën në Shqipëri edhe para apo pas pushtimit italian, u dëshmua se këto troje shërbyen si stacione shpëtimi në kohën e rrezikut të madh si shpallja e platformës *Zgjidhja Përfundimtare*.

Libri mban gjithaq mbi modelin modern të një ambasadori edhe në kohët e sotme, një model aspak i diplomatit në karrierë dhe po aq i atij që vihet nën presion të diplomacisë ekonomike, që, në fakt, nuk mund ta bëjë dot i vetëm pa shtetin e tij. Libri është një udhërrëfyes i disa sferave në dukjen dhe padukjen e tij se si një diplomat duhet të jetë, një model i vërtetë i pakohë dhe universal. Bernstein shfaqet aty më saktë se çdo përcaktim tjetër do të shkruante dikush; një lord anglez, një amerikan sportiv dhe një zotëri europian. Pjesëtar i një race të

njohur për zgjuarsinë dhe idealet e larta, por e persekutuar dhe e torturuar prej fanatizmit të verbër dhe shovinizmit të egër të vendeve të çmendura. I rritur në qarqet më të larta intelektuale të kohës së tij, i ushqyer me parimet e dashurisë për lirinë e kombit të Linkolnit, ai e njeh botën nga të dyja anët, atë të errëtën dhe të shndritshmen. Ai është një prej pionierëve të botës së re.

Herman Bernstein e pat filluar jetën e tij intelektuale si poet e vazhdoi si përkthyes, si gazetar dhe analist, si polemist për ta përmbyllur si diplomat. Në jetën e mikut të shqiptarëve, si ai cilësohet prej gjithë atyre që e njohin në aureolat shkencore, ndikimi i gjithë aspekteve që plotësojnë njohjen e figurave të mëdha apo një periudhë historike, ka qenë

jashtëzakonisht i madh. Kjo përcjellje informacioni, ky tejçim zërash prej lartësie të padiskutueshme mendimi, që autori ndan me lexuesin është pasioni që mban ndezur vullnetin e së nesërmes për të pritur me guxim dhe dashuri, të rejat e një bote tjetër, botën e dijes. Çfarë është kjo për autorin, vlen të mbetet një sekret mes tij dhe librit, siç, në fakt, çdo autor e ka një sekret kur nxjerr prodhimin e vet. Ajo që kuptojmë se çfarë ka ndodhur mes tij dhe personazhit karizmatik të diplomacisë amerikane, e që ka hyrë me aq dashuri në analet e historiografisë shqiptare, është ndjesia e një magjie, një magjie shpirtrash mes të dyve që vazhdimisht ka dëshirën për të kompozuar dhe çliruar mirësi.

Çdo herë që një libër botohet mbetet një dritare e bukur për botën, sepse po aq herë ai shfaqet, godet me romuz trupat e 'heronjve' shëmtarakë të ditës me të cilën është mbushur aureola jonë sociale, ekonomike dhe politike. Libri i Bernstein mbetet një libër për heronj të dashuruar pas lirisë dhe evolucionarizimit për të pushtuar të gjithë ata të cilët, të mësuar me një epokë të re promovimi të vetëkënaqurish të patrazuar, presin të rishkruajnë apo rilindin një kujtesë apo një vizion të ri vlerash, mbi skeletet e zverdhura të pa gjak e të pajetë të personazheve, kontributorët e zëshëm të shëmtimit që i shpalosin këtij vendi, në çdo betejë me të cilën ai përballe

AMBASADORI I DASHURUAR ME SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT

Mal Berisha në Monografinë kushtuar Herman Bernstein

Shkruan Kadri Tarelli

MIGJENI OKSH 18.04.2020



Një falënderim për historianin, shkrimtarin dhe studiuesin z. Kadri Tarelli i cili i ka kushtuar aq shumë vëmendje studimit të librit "HERMAN BERNSTEIN" Ndjehem i nderuar për analizën që i ka bërë figurës së tij dhe nëpërmjet tij edhe librit!

Respekt dhe nderim!

Mal Berisha

Po mendoja të shkruaja diçka mbi librin monografi: "Herman Bernstein, Ambasador i SHBA-ve në Mbretërinë Shqiptare, 1930–1933", që kur para do kohësh, autori Mal Berisha bëri përurimin edhe në qytetin e Durrësit. E kisha lënë ta lexoj më nge, sepse libri është shkruar me germa të vogla dhe do durim e mundim për ta përfunduar. Koha u gjet, jo nga unë, por nga "Virusi", që në këtë pranverë 2020, na ngujoi nëpër shtëpitë tona, si Oso Kuka, dikur në "Kullë t' barotit".

Tani ndjej pendim që e lashë të presë kaq gjatë, sepse ky libër i shkruar me mjeshtëri e art fjale, ka peshë të rëndë për nga materiali historik, nga dokumentet e shumta të gjetura nëpër arkivat e botës, por edhe nga cikërrimat jetësore, që e

shoqërojnë “Heroin e librit” në udhëtimet e tij nëpër Shqipëri e nëpër botë. Janë ndodhi të ndryshme, apo vogëlima po i quaj unë, të gjetura e të hedhura me kujdes, që i japin librit lëng jete, bukuri dhe kënaqësi leximtare e shpirtërore, për të mos përsëritur falën e thënë shpesh, “Libri nuk të lëshon nga dora”.

Nuk po marr përsipër të gjykoj apo të shtjelloj strukturën e këtij libri, që do ta quaj një monografi e mrekullueshme për një njeri të mrekullueshëm, siç është ambasadori Herman, sepse është zgjedhje e autorit, për t’i thënë gjërat ashtu siç i mendon ai dhe aq sa do ai. Madje nuk ka rëndësi vendosja e materialit, duke gjykuar se më e qenësishme është vërtetësia dhe harmonia e të veçantës me të përgjithshmen.

E them këtë, sepse lexuesi do të çuditet disi, kur të shikojë si pjesë të parë të vendosur: “Herman Bernstein në Shqipëri”, ndërkohë në pjesën e dytë: “Herman Bernstein, para ardhjes në Shqipëri”. Kjo vendosje nuk është një truk i autorit, por një vendim i arsyeshëm, nisur nga gjykimi i materiali që shtjellohet. Gjithsesi e rëndësishme dhe e dobishme është, njohja me shumë të dhëna historike, disa të pa njohura më parë, mbi ngjarje dhe personazhe që kanë pasur rol dhe ndikim mbi gjendjen, vijimësinë dhe ardhmërinë e kombit dhe të shtetit shqiptar. E gjitha, e vështruar në një periudhë tepër të trazuar brenda vendit, lakminë e fqinjëve tanë të pa ngopur, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, ku luhej politika e madhe.

Kjo monografi është një libër i shkruar me shumë dashuri e përkushtim, për të qenë sa më i vërtetë, aq edhe i besueshëm për lexuesin, mbështetur në kulturën letrare, artistike, historike dhe politike, goxha te plotë. Kam përshtypjen, se autori është përpjekur dhe lodhur shumë, jo thjesht për të grumbulluar material, pasi është i gjerë dhe tepër i rëndë, i shtrirë në kohë dhe në hapësirën e disa vendeve të botës, por për ta sistemuar, diku edhe shkurtuar, për të dhënë vetëm thelbin.

Nuk mburrem, por kam lexuar shumë monografi, jam përpjekur të shkruaj edhe vetë, dhe sa herë që nis lexoj, them me vete: Sa kokë krisur paska kjo botë, që guxojnë të hyjnë e të shkruajnë monografi, aq më shumë për personalitete të tilla si ambasadori Herman, që

rrok disa disiplina: të gazetarisë, letërsisë, diplomacisë dhe politikës, ku hyn dhe nuk del dot.

Analiza e ngjarjeve të kohës, sipas ambasadorit Bernstein, të cilat i përjeton vrullshëm, duke qenë vetë aktor dhe spektator i paanshëm në gjykim, është i pa ndikuar nga askush. Aq më pak nga politika dhe qejf-mbetjeve alla shqiptare, pavarësisht simpatisë dhe dashurisë që ai ndjeu dhe gëzoi, për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ai ishte dhe mbeti i drejtë me veten dhe me detyrën, madje duhet shtuar: ai ishte mjeshtër i analizave diplomatike. Kjo na bën nder, ne si komb dhe si shtet, (kemi parasysh i sapo formuar). E nënvizoj këtë, pasi në shumë shkrime të tij, të botuara në gazetat më të njohura të Amerikës, pa mëdyshje zbardhen

shumë pjesë të jetës shqiptare, disa të pa thëna më parë, të pa njohura, apo të mësuara keq, duke paragjykuar politikisht edhe sot e kësaj dite, atë periudhë aq të zhubravitur në kancelaritë e shtetit dhe të shteteve.

Ambasadori, apo Ministri fuqi plotë, përfaqësues i SHBA-ve, shtetit më të fuqishëm të botës, në Shqipëri, në "Tokën e harruar të Europës", njohu personalisht shumë funksionarë të shtetit shqiptar, është fjalë për Mbretin Zogu i I-rë, Faik Konica, Mehmet Konica, Lef Nosi, artistin Aleksandër Moisiu, të cilit i përktheu dramën "I burgosuri", nga gjermanisht në anglisht. Ai njohu po kaq mirë shpirtin liridashës, mentalitetin e kohës, harmoninë fetarë, njëkohësisht edhe gjendjen e vështirë ekonomike, dallimet sociale e

krahinore, prapambetjen arsimore, kulturore dhe dëshirën e papërmbajtur të shqiptarëve, për të bërë shtet dhe përparim shoqëror. Në letrën që i dërgonte, Sekretarit të shtetit, më vonë president i SHBA-ve Herbert Hoover, ai shprehet:

"Shqiptarët janë njerëz të tillë, që më mirë vdesin, sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërim të vet, sesa të qahen… Ata janë popull tragjik, por një racë heroike".

Pikërisht mbi këto dukuri të qëmtuara imtësisht, ai zbuloi shpirtin dhe besën e shqiptarëve, dashurinë ndaj të tjerëve pa dallime kombesh, siç ishin hebrenjtë, duke rrezikuar jetën e tyre dhe familjen. Ai u bë mik dhe mbeti mik i shqiptarëve, si rrallë kush në historinë

diplomatike dhe marrëdhëniet ndër shtetërore të shtetit shqiptar. Na duket si çudi, kur lexojmë:

"Bernsteini është shqiptarizuar, shprehen qarqet diplomatike italiane".

Kjo do të ishte vetëm gjysma e të vërtetës mbi portretin e këtij gazetari, poeti, shkrimtari, përkthyesi, politikani dhe veprimtari të pa lodhur, siç ishte Bernsteini. Detyrimisht po ve në dukje, si vlerë e shtuar e heroit të librit, se ai kishte njohje personale të hershme me presidentët, Teodor Rusevelt, Woodrow Wilson, Herbert Hoover. Jo kushdo mund të arrinte në këto maja të "Yjeve" të politikës, që drejtonin botën.

Nuk çuditemi kur vizitojmë galerinë e shumë personaliteteve të tjerë, po kaq të rëndësishëm në politikë dhe në fusha të tjera, të artit, letërsisë, kulturës, shkencës, ekonomisë, etj. Në libër do të gjeni disa prej tyre: Austen Chamberlain politikan britanik dhe fitues i çmimit "Nobel", historianin Tarle, të famshmin Leon Tolstoi, shkrimtarin dhe dramaturgun George Bernard Shaw, shkrimtarin Leonid Andrejev, Leon Trocki, politikanin dhe organizatorin e revolucionit të Tetorit në Rusi, skulptorin e njohur August Rodin, shkrimtarin amerikan Teodor Drajzer, shkencëtarin Albert Ainshtajni, etj, etj, personazhe e burra shtetesh.

Personaliteti i ambasadorit është i pamat. Madje duhen studime të tjera që t'i japin hakun që meriton. Unë dua të ndalem pak te librat e tij, të

cilat janë një tjetër galeri shkencore dhe artistike njëherazi, duke i lënë kulturës botërore një tjetër pasuri. Përmend:

. Revolucioni Bolshevik i Tetorit dhe telegramet "Willy-Nicky".
. Herbert Hoover. Njeriu që solli Amerikën në botë.
. A mund ta shmangim luftën?

Po qëndroj fare pak tek libri i tretë, pasi bën fjalë për afrimin e Luftës së Dytë Botërore dhe kërcënimin që po i vinte njerëzimit. Ai nuk e pa dhe nuk e përjetoi pështjellimin e botës mbarë, por e parandjeu dhe klithi me zë të fortë, duke i shkruar 100 personaliteteve të kohës: "A mund ta shmangim luftën?". Ai ishte njohës i përkryer i lëvizjeve politike dhe ushtarake, ndaj u përpoq

që të nxiste shpirtin paqedashës. Pavarësisht se ishte njeri realist, me këtë thirrje, duket që mbetet idealist dhe fisnik në shpirt. Kaq mundi të bëjë ai, megjithëse fare mirë e dinte, se janë të tjera forca që e kurdisin orën e tmerrit dhe venë në lëvizje akrepat, ndërsa politikanëve u mbetet në derë, fitorja dhe humbja, nderi dhe turpi, lavdia dhe mallkimi, përbuzja dhe harrimi. Pas pak vitesh, pasi ai ndërroi jetë, botës ju vu zjarri, që mori miliona të vrarë, mes tyre edhe miliona hebrenj, njerëz të racës së vet.

Secili nga ne mund të flasë e të shkruajë shumë, për librin dhe në veçanti për Ambasador Bernstein, me të gjitha meritat e tij, si njeri tepër i zgjuar, i ditur, guximtar, këmbëngulës dhe i duruar. Por…, më pëlqen të ve në dukje një tjetër cilësi, që ne shqiptarët duhet ta mbajmë si

hajmali, apo gjerdan floriri: “Dashurinë për kombin e tij”. Ai i qëndroi besnik Amerikës dhe detyrës ndaj këtij vendi, që i dha liri dhe mundësi të bëhej ai që u bë. Diçka madhështore në figurën e tij është synimi, se brenda lirisë, pa e cenuar atë dhe interesat e Amerikës, e vuri veten në shërbim të kombit hebre, për të krijuar atdheun, Izraelin, ku të mbështeste kokën, trupin dhe shpirtin e tij. Në këtë projekt të paimagjinueshëm për nga përmasat, ai nuk ishte vetëm dhe i vetmi, por bashkë me plot të tjerë, vuri një gur të rëndë në themelet e shtetit të ëndërruar, por që nuk arriti ta shohë të realizuar sa ishte gjallë. Gjithsesi figura e tij është për t’u admiruar, për atdhedashuri, si shembull për të gjithë ata që punojnë e luftojnë për lartësimin e

kombit dhe atdheut të vet. Ai mbetet simbol adhurimi, veçanërisht për brezat e rinj.

Në fund të librit, si një vlerë të shtuar, më bëjnë përshtypje shumë veprimtari të organizuara në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA, nga autori i librit, diplomati ynë Mal Berisha, ku duke paraqitur librin e tij, gjen rastin të shpalosë para botës, cilësitë dhe tiparet më të mira, më të bukura të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Kam bindjen se i gjithë libri është një "Shkollë" suksesi, ku diplomatët e rinj shqiptar, do të gjejnë mësime të vyera për veprimtarinë e tyre në dobi të detyrës dhe të mbidetyrës: "Çështja jonë kombëtare". Leximi dhe studimi i kësaj përvoje të pasur diplomatike, mbase bëhet mësim edhe për strukturat tona shtetërore, për

të zgjedhur në përfaqësitë tona diplomatike nëpër botë, njerëzit më të përgatitur, më të përkushtuar për detyrën, mbase edhe atdhetarë të thekur.

Bindem plotësisht, kur arrij në mbyllje të faqes së fundit të librit, se Diplomati ynë Mal Berisha, bëri një detyrë shqiptarie, sepse "Mikut të shqiptarëve", ambasadorit Herman Bernstein, i ngriti "Monument" në tokën shqiptare, duke e lartësuar në këtë libër me përmasa të mëdha, me vlera njohëse, mësimore dhe edukative.

Mirënjohje dhe përshëndetje autorit Mal Berisha! Falënderim dhe suksese me vepra të tjera, po kaq të mira e të rënda!

Durrës më: 09, mes pranvere, 2020.

MIKU I MADH I SHQIPTARËVE, DIPLOMATI I NDERSHËM DHE I DREJTË HERMAN BERNSTEIN

Shkruan Shpendi Topollaj

Rreth librit monografik të autorit Mal Berisha



E lexoja librin e diplomatit **Mal Berisha** për një tjetër diplomat, madje edhe të një tjetër kohe, Herman Bernstein, dhe më sillej nëpër mendje ajo shakaja e Henri Kizingerit, kur thosh se:

"Më telefonoi ministri i Punëve të Jashtme të Amerikës Heig dhe më ngarkoi me misionin t`u shpjegoj politikën e jashtme të qeverisë sonë kinezëve, secilit më vete".

Natyrisht që ky nobelist që afroi politikisht vendin e tij me Kinën dhe Vietnamin e dinte më mirë se kushdo, se detyra e një diplomati, e ca më shumë ajo e një ambasadori, është nga më të vështirat dhe më seriozet.

Është njëkohësisht një detyrë që përveç ndershmërisë, kërkon edhe vlera të veçanta intelektuale dhe sidomos përkushtim. Duke i pasur këto cilësi si rrallë kush, brenda frakut të tij diplomatik, ish konsulli ynë i Përgjithshëm në Stamboll dhe më pas si ambasador në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe në Irlandë, Mal Berisha, në morinë e librave të tij mjaft të mirëpritur, kësaj here ka zgjedhur të trajtojë një figurë emblematike, por paradoksalisht, pak të njohur, si ajo e amerikano – hebreut Bernsteinit, i cili nga periudha 1930 deri në vitin 1933 kreu detyrën e ambasadorit të SH.B.A. – ës në Shqipërinë e mbretërimit të A. Zogut.

Shekspiri diku ka thënë:

"Jeta është e shkurtër, por e vërteta rron shumë dhe arrin larg".

Dhe ja tek e kemi kaq pranë dhe kaq të qelibartë (siç e thotë ky mbiemër), veprën e një miku të shquar si ky njeri, i cili kur u largua nga vendi ynë meritoi dekoratën më të lartë "Kordoni i Madh i Urdhrit të Skënderbeut" dhe cilësimin nga shtypi i kohës si "…një prej pionierëve të botës së re." Është shumë domethënëse e vërteta historike se gati të gjithë vizitorët që kanë ardhur në Shqipëri, jo vetëm janë mrekulluar nga bukuritë natyrore dhe mikpritja e popullit tonë tejet të varfër, por dhe janë dashuruar me Shqipërinë dhe janë bërë

apologjetë të çështjes tonë kombëtare. Ne u detyrohemi shumë atyre.

Dhe këtë bën edhe autori Mal Berisha me librin e tij, i cili nuk përqendrohet vetëm te vitet e protagonistit në Tiranë, por rrok gati gjithë veprimtarinë e tij si poet, prozator, publicist, përkthyes, gazetar, politikan, atdhetar e mik influent i shumë e shumë personaliteteve që ndikuan në historinë botërore, duke na e dhënë të plotë portetin e tij. Vetëm kështu mund të kuptohet sesa rëndësi i vinin vendit tonë, dhe sa respekt kishin për popullin tonë, presidentët e nderuar të Amerikës si Roosevelt, Wilson dhe Hoover, për të vazhduar deri në ditët tona. Janë disa momente që do të shërbejnë përjetësisht si gur themeli në miqësinë me SH.B.A. – në, si ajo deklarata e Presidentit Wilson në Konferencën

e Paqes në Paris më 1919 – tën, për moslejimin e coptimit të vendit tonë, vendosja e marrëdhënieve diplomatike, ndihma për çeljen e shkollave emërmëdha, përkrahja e luftës nacional – çlirimtare, trajtimi mëse njerëzor i emigrantëve tanë në Amerikë, ndriçimi i mendjeve të shqiptarëve për rrezikun komunist, ardhja e zotit Bejker pas shembjes së diktaturës, më 23 qershor të vitit 1991, vizita e presidentit George W. Bush, pas të cilës u anëtarësuam në NATO, ndërhyrja ushtarake për çlirimin e Kosovës nga barbaria serbe e Millosheviçit etj. etj.

Kur Bernsteini mbërriti në Shqipëri, situata ekonomike, politike e sociale ishte aspak e mirë. Por ai ishte i prirur ta gjente të mirën dhe të bukurën edhe duke parë nga dritarja e selisë së

tij. E përshkruan atë me një romantizëm të ëmbël, e quan atë pamje magjepsëse dhe të çuditshme, tek e cila sheh një peizazh të jetës shqiptare me tërë format dhe ngjyrat e saj të larmishme. Ai ua përshkruan lexuesve amerikanë, që s`kanë asnjë dijeni për këtë vend e këta njerëz, me shumë ngrohtësi dhe me besim se shumë shpejt do të bëhet i zhvilluar si tërë popujt e qytetëruar të Evropës. Ai i fton ata ta vizitojnë këtë vend pa konflikte fetare, se po u vonuan, do humbasin shumë. Duhet ta njohin mikpritjen proverbiale dhe kostumet e bukura e të habitshme.

U thotë atyre që të shpejtojnë se shumë nga magjia e këtij vendi po zhduket, pasi po hyn e reja e jetës moderne. Dhe është po ky mik i yni që teksa kërkon nga qeveria e tij ndihmë për

arsimin dhe bujqësinë tonë, me shumë dashuri i drejtohet në një relacion presidentit të tij me këto fjalë: "Shqiptarët janë njerëz të tillë që më mirë vdesin, sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërimin e vet, sesa të qahen… Ata janë popull tragjik, por një racë heroike…" Dua të besoj se edhe vetë udhëheqësit shqiptarë, nuk mund të flisnin më me entuziazëm për popullin e tyre. Ky ambasador i njihte mirë dhe kurrë nuk i kapërcente detyrat e tij.

Mal Berisha, ky shqiptar i kulluar, dhe me kulturë superiore, ka hulumtuar gjatë rreth kësaj figure kaq interesante dhe ka gjetur mjaft materiale nëpër arkiva që tregojnë se Herman Bernsteini ishte një mbrojtës i palëkundur i aspiratave tona për liri e pavarësi. Vlen të

theksohet qëndrimi i tij ndaj çdo lloj synimi për ta pushtuar, shfrytëzuar apo për të përfituar nga mundësitë që Shqipëria kishte. Ai, mban qëndrim tepër të drejtë dhe demaskues, veçanërisht ndaj planeve djallëzore të Musolinit. Ai në tërësi, e shpall dyshimin e tij për tendencat aneksioniste të fashizmit dhe të Hitlerit, aventurat e të cilëve do ta çojnë botën në një luftë tjetër botërore. Mesa duket të çmendurit e Evropës, ende nuk kanë nxjerrë mësime nga kasaphana e Luftës së Parë Botërore. Edhe diplomatët italianë e ndjekin si hije çdo lëvizje dhe çdo qëndrim të tijin. Mali, na i ka dhënë në ligjeratë të drejtë, raportimet e tyre për këtë ambasador që ata e quajnë të shqiptarizuar dukshëm në çdo veprim të tijin. Madje, aq sa i gëzohen largimit të tij, aq edhe i

tremben faktit se ai duke qenë me ato talente, pra me botime librash, artikujsh, novelash dhe mundësi politike, do të vazhdojë të përkrahë këtë vend dhe të mbështesë me këshillat e tij si shpëtimtar mbretin Zog. E për më tepër, sipas tyre, ky njeri që hapi shkollën teknike dhe atë të Golemit e Kavajës, ka mundësi të sjellë edhe ndihma të qenësishme ekonomike. Kapitull më vete në libër, autori i kushton marrëdhënieve të sinqerta dhe mjaft të përzemërta me vetë mbretin.

Për më tepër, ai nuk mjaftohet me vlerësimet dhe largpamësinë e këtij burri shteti, por edhe i kërkon dhe shkruan të parën biografi të tij. Sa baltë e helm është hedhur mbi figurën e A. Zogut nga komunistët. Por si ka mundësi që një burrë kaq inteligjent, një njohës i shkëlqyer i

historisë, një diplomat me përvojë, një njeri i lirë në mendime, një njeri që nuk i kursen kritikat për askënd, flet për të me aq konsideratë? Mbi të gjitha, ai vëren një mprehtësi mjaft të hollë në vështrimin e problemeve si me fqinjët, ashtu edhe kur diskutohen farsa ndërkombëtare. Është me mjaft domethënie vetëm analiza që A. Zogu i bën propozimit Briand për parandalimin e militarizimit dhe për pasojë edhe të vetë Luftës së Dytë Botërore. Ja si shprehet Zogu në bisedë me ambasadorin: "Unë kam vënë re se në këto konferenca problemet më të vështira janë ato që mbeten për t`u zgjidhur në mbledhjen e ardhshme e kështu me radhë dhe pastaj fillon akumulimi i problemeve dhe brengave më të vështira, të cilat nuk mund të zgjidhen dhe as të

rregullohen, pasi vërtetë që aty nuk ka dëshira për t`i zgjidhur ato dhe për shkak se secili prej burrështetasve që shkojnë në ato konferenca është i përkushtuar t`i zgjidhë këto probleme sipas interesave të tij dhe jo nga pozicioni i mbarëvajtjes së përgjithshme.

Kjo është arsyeja përse unë mendoj se shtetet e Bashkuara të Evropës, siç i propozon Briandi, do të mbeten vetëm një ëndërr boshe, një gjest madhështor, i ndërmarrë me qëllim që Franca, kur të vijë ajo ditë, të realizojë përpjekjet e saj për të bashkuar Evropën, me qëllim që të sjellë paqen." Asnjëherë H. Bernstein nuk harron të theksojë se shqiptarët janë pasardhës të Skënderbeut, dhe që edhe sot e kësaj dite ata vishen me të zeza për vdekjen e këtij heroi të papërsëritshëm. Ai thekson se për të, në vitin

1873 ka shkruar edhe vetë poeti amerikan, pedagogu i Harvardit Henri Uodsuërth Longfellou, dhe më vonë i ardhuri në Shqipëri më 1908 – tën Charles Telford Ericksoni i cili e niste kështu poemën e tij:

"Ti dorën nuk e zgjate drejt skeptrit njollagjak,
As i trishtë nuk kërkove të shprishurën kurorë,
Përballë i dole që vetë të merrje hak,
Ndaj atij tirani djemrrëmbyes e idhnak,
Që dheun tënd kishte shtënë në dorë."

Mal Berisha vë në dukje se qëllimi i shkruarjes së këtij libri ka qenë të ndërthurrë tri shtete, pra tre popuj, që kupton veç atij shqiptar dhe amerikan edhe popullin hebre që aso kohe kishte mjaft probleme, pasi jo vetëm luftohej paturpësisht, por edhe bënte përpjekje të

jashtëzakonshme për t`u organizuar si gjithë shtetet e popujt e tjerë të botës. Kjo populllsi semitike me Abrahamin në krye, ishte vendosur në Palestinë tetëmbëdhjetë shekuj para lindjes së Krishtit dhe ende persekutohej e përndiqej.

Kishte ardhur koha që vepra e Mojsiut për bashkimin dhe organizimin e tyre të përsëritej.

Mal BERISHA

ALBANIAN RIGHTEOUS AND THE ALBANIAN BESA

With Trude Grünwald - Prof. Scarlett Epstein

Albania saved my life

Excerpts in English as a courtesy to the Solomon Museum of Berati

By Jay Grenby, February 3, 2014

The role of Albanians in rescuing Jews from the Nazis was told to more than 400 people at a Pinner Synagogue HMD event by the country's UK ambassador, Mal Berisha.

Albania was the only occupied country in Europe to end the war with more Jews than at the beginning, Mr Berisha said. "It was also the only European country in which not a single

Jew was handed over to the Nazis or lost his life. Jews were fed, sheltered, hidden in places of safety, offered aliases and family love at great personal risk by their rescuers among a population that was largely Muslim."

Their heroism reflected "besa", a code of honour followed by Albanians irrespective of religion. Based on the principle that "the house of an Albanian belongs to God and the guest", it requires that citizens be ready to receive a guest with bread, salt and an open heart — and must defend their guest's honour even at risk to their own life.

A large contingent of young Albanians living and studying here were among the guests. The event also included the screening of a

documentary in which Jews and Muslims give first-hand accounts of the moral and physical courage of Albanians, both before and during the war.

"Pinner Synagogue has been delighted to have been able to host this recognition of remarkable cross-religious heroism to such a diverse and large audience," said organizing committee chair Gaby Glassman. "It was so uplifting to hear the many stories of positive Muslim and Jewish interaction, even at the darkest moments of history."

She announced that the Pinner community had planted a tree in the Lord Sacks Forest in Jerusalem "in grateful appreciation of the courageous acts of the Albanian people in

rescuing and sheltering Jewish refugees" and presented the ambassador with a commemorative certificate.

“A PROMISE AND A PEOPLE: THE ALBANIAN JEWS AND THE HOLOCAUST.”

J.F Kennedy School of Government
79 J.F Kennedy St. Cambridge MA 02138

Following the International Holocaust Remembrance Day, a special event, co-sponsored by the Jewish Caucus, Israel Caucus, and European Club, featuring Mr. Mal Berisha, a distinguished Albanian ambassador of career, is going to bring the Albanian – Jewish History to the fore.

This event, open to the public, is entitled

It will be held on February 1, at 7 p.m. in the premises of Harvard Kennedy School (Starr Auditorium, Belfer Building, Second Floor, John F. Kennedy School of Government, 79 John F Kennedy St. Cambridge, MA 02138.)



Albania, the only Muslim-majority country in Europe, emerged from the atrocities of the

Holocaust with a tenfold increase in its pre-war Jewish population. Based on the highest moral values of "BESA", the Code of Honor for Albanians, thousands of Jews were sheltered unconditionally by ordinary people, mostly in rural areas of the country, the announcement explains.

During this presentation, Mr. Mal Berisha, a writer and a seasoned diplomat (the last posting was an Ambassador of Albania to the United Kingdom), is expected to examine the political, cultural, and historical accounts through the eyes of a Jewish American Ambassador to Albania, the Monarch of Albania, and everyday Albanians who risked their lives to come to the help of fleeing Jews.

Ambassador Berisha will offer remarks, followed by a moderated discussion and Q&A with journalist and public radio host, Christopher Lydon (Radio Open Source, WBUR).

"If there is a single Gentile nation that has the right to commemorate, being proud of its history of the time of Holocaust, that is the Albanian Nation. To remember that Day, I have the honor and privilege to hold this presentation, Mr. Mal Berisha said earlier this week via a posting to his official Facebook.

In 2014, Berisha presented his first English book in Manhattan at the YIVO Institute of Jewish Studies in New York City and the US Embassy in London: "Herman Bernstein, US

Ambassador to Albania" where he detailed the close relations between Jews, Albanians and the United States Government. The work of the U.S. Ambassador to Albania, Herman Bernstein (1930-1933), championed positive Albanian-Jewish relations.

This book raised a lot of interest but even more the fascinating spectrum he found to explore the relations between the Albanians and the Jews.

Ambassador Berisha, has served as the Ambassador of the Republic of Albania to the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland and Ireland from 2012 to 2015. Previously Berisha served as General Consul of Albania to Istanbul from 1993-1997.

Berisha has graduated from the Academy of Arts of Albania. His life has been tightly linked with cultural anthropology in Albania. He is a history scholar and has published a number of books and articles about various subjects of history, culture and diplomacy.

US AMBASSADOR IN ALBANIA BERNSTEIN – A MODEL OF A GREAT DIPLOMAT

As a diplomat, I have learned from Herman Bernstein that everything we write, even the notes we scribble and the business cards we exchange, are important records to be preserved.

Mal Berisha

Herman Bernstein was born on September 21, 1876 in a village named "Vladislavov" in Russian, called "Neustadt-Schirwindt" in German or "Naishtot" in Hebrew, located

between the borders of Russia and Germany in today's Lithuanian territory. He is the son of David and Marie Bernstein. His family immigrated to the United States in 1893. He studied in the States and married Sophie Friedman in 1901. His father was a Talmud scholar but died when Herman was a young boy. *He was assigned as the United States Ambassador to Albania by the 31st US President Herbert Hoover. He served in Albania from February 1930 to September 1933, during a period marked by Albania's struggle under King Zog to maintain its independence between Italy and Yugoslavia.*

The activity of Herman Bernstein goes far beyond of the work of a journalist, traveller, writer, political analyst or historian. Bernstein, as one of the educated elite of his times, played

a historic role despite the fact that he was not a politician. He wrote a series of books including:

The Flight of Time, In the Gates of Israel, Contrite Hearts, *Celebrities of Our Time, The Road to Peace, The History of a Lie, With Master Minds, Willy – Nicky Telegrams, Herbert Hoover – The Man Who Brought America to the World.*

He translated a number of important literary works by figures such as Maxim Gorky, Leonid Andreyev, Leo Tolstoy and Ivan Turgenev, from Russian into English.

While traveling through Russia and Europe, he interviewed some of the greatest men of his time. The interviews, with commentary, were published in a book entitled *With Master Minds*:

In his introduction he writes:

"It has been my good fortune to interview some of the master minds of Europe—the foremost authors, scientists, philosophers, statesmen and artists. I hope I have given to the reader the prophetic earnestness of Leo Tolstoy, the zeal and optimism of Elio Metchnikoff, the brilliant whimsicalities of George Bernard Shaw, the clever statesmanship of Count Sergius Witte, the keen penetration or Professor Henry Bergson, the passionate power of Leonid Andreyev, the analytical force of Harden, the love of the beautiful of August Rodin, *the fearless progressiveness of Havelock Ellis, the many sided erudition of Maxime Kovalevsky, and the quaint philosophy of the Sheikh-Ul-Islam."*

Bernstein, a friend of three US Presidents, Theodore Roosevelt, Woodrow Wilson and Herbert Hoover

What makes this publication more important is the foreword of Theodore Roosevelt, then a former US President (1901-1909), who wrote the following letter to Bernstein on November 6, 1917:

My dear Bernstein,

I congratulate you on the noteworthy service you have rendered by the discovery and publication of these letters. They illuminate with a glare like a flashlight, the dark places of diplomacy of despots; they show what diplomacy in autocratic nations really is and

what it has done and sought to do, right up to the present time. Let me repeat, my dear sir, that in publishing these letters you have rendered a signal service to this nation and to all mankind.

Very sincerely yours

Theodore Roosevelt

In 1919 Bernstein went to Paris with the American Delegation as a journalist. He reported from Paris for many American newspapers. The story of the Paris Peace Conference is very important for Albania and is entirely linked to the position of the United States, represented by President Wilson and to the contributions of an American missionary, Charles Telford Erickson. It was Charles

Telford Erickson who informed President Wilson in daily briefs about Albania's history and why it was facing that situation

In 1929 Herbert Hoover became the 31st President of the United States and would serve until 1933. It is worth mentioning that President Hoover had served as the Secretary of Commerce from 1921 to 1928. In 1925 he gave a donation of 10,000 US dollars on the condition of anonymity (because it was considered a conflict of interest) for the Agricultural School of Kavaja in Albania, soon to be established by Charles Erickson. Bernstein wrote his book *The Man who Brought America to the World dedicated to President Hoover.*

BERNSTEIN — AMERICAN MINISTER IN ALBANIA

After such an excellent carrier, Bernstein assumed his position as American Minister to the Albanian Kingdom on February 17, 1930. He presented his letters of credence to King Zog of Albania on April 28, 1930 and relinquished on September 24, 1933.

Bernstein explains in his diplomatic reports why Albania is referred as the most dangerous zone of Europe where a war is likely to start. He gives a picture of the country in such a beautiful way: "Albania has been called 'Europe's Forgotten Land,' 'Cinderella among the Nations,' 'Land of the Paradox,' 'Key to the

Adriatic,' and 'the Belgium of the Balkans. He writes:

"Albania's history dates back to the pre-Christian era. The city of Durazzo, known ancient times as Durrahium, is twenty-seven centuries old. The Albanians are believed to have descended from the ancient Illyrians. Alexander the Great of Macedon was a son of an Albanian princess. The town of Butrint, in Southern Albania, where recent excavations brought back age-old scenes immortalized by Virgil, has a remarkable amphitheater more than two thousand years old. Feniks Hill near Saranda in Southern Albania is surrounded by series of massive walls which makes the place one of the most highly fortified and largest acropolises of the classic world. The tribes of Epirus, the Greeks, the Romans, the Slavs, and finally the Turks took possession of Albania and endeavored to suppress

the people by imposing their own nationalities, languages, and customs upon the sturdy mountaineers, but without complete success. Even the five hundred years of Turkish rule, during which they were forced to embrace Muhammadanism, did not thwart the indomitable spirit of independence among the North Albanian mountaineers, and notwithstanding the most drastic suppression of Albanian schools, books and newspapers, the Albanian language has survived."

Reasons why Albania has lost faith in the Italians?

